Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr.060/01-22001/22
Kaçanik, 21.01.2022

**FTESË PËR MBLEDHJE**

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e I-r (Parë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2022.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 28 Janar 2022 ( e Premte) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit,
Kemal Murseli

REPUBLIKA E KOSOVËS * KOMUNA E KAÇANIKUT * OPŠTINA KAČANIK * REPUBLIKA KOSOVA

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 28.01.2022, do të shqyrtohet ky:

**REND PUNE**

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.12.2021;
2. Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;
3. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;
4. Raporti i punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara, për vitin 2021;
5. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;
6. Informatë e drejtorisë së Arsimit, për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor 2021/2022;
7. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës;
8. Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës- AAK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AAK.

**Shtojca**; Materialet për pikët sipas agjendës.

| | |
|---|---|
| **Republika e Kosovës** | **Komuna e Kaçanikut** |
| **Republika Kosova** | **Opština Kacanik** |
| **Republic of Kosovo** | **Municipal of Kacanik** |

**01Nr. 60/01-38196/21**
**Kaçanik, 29.12.2021**

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **II** (mbledhje e rregullt) e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2021 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 29.12.2021. Mbledhja është mbajtur në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, më fillim pune në ora 11:00.
Nga përbërja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje fillimisht ishin 26 anëtarë, në ndërkohë arriti edhe anëtari Betim Shala, kështu që përbërja e KK, konstatohet së është me 27 anëtarë.
Prej strukturave ekzekutive të komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës- Besim Ilazi, drejtorët e drejtorive komunale në detyrë: Bahri Selimi, Ramadush Osmani, Festim Neziraj, Fatmir Loku, Zahir Doda, ndërkaq nga zyrtarët e komunës ishte Fatlume Guri-Selimi, Bejtulla Dalloshi dhe Arbnora Kuka.
Nga qytetarët prezantohet 1: Xhevdet Tifeku.
Nga OSBE- mbledhjen e monitoroj Gazmend Murseli. Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Tel, prezencës nga Vjosa Ahmetaj- Zyrtare e lartë për monitorim të Komunave në MAPL.
Mbledhjen e kryesoi Kemal Mërseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtëse Makfire Malsiu.
Para se të fillonte mbledhja, të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës u pajisën me laptop nga drejtori në detyrë i Administratës së Përgjithshme, Festim Neziraj dhe zyrtarit të IT, Bejtulla Dalloshi.

**Kryesuesi i Kuvendit z. Kemal Mërseli:** Të nderuar pjesëmarrës të kësaj mbledhje, së pari iu përshëndes të gjithëve iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj pjesëmarrjen duke i thirrur emër për emër, pasi që nuk kemi pajisje elektronike me konstatua pjesëmarrjen. Kushte pune për t'u mbajtur mbledhja ka, andaj e hapi mbledhjen e dytë të radhës apo mbledhja e parë e rregullt për vitin 2021, data 29 dhjetor 2021, me këtë:

## REND PUNE

1. Betimi Solemn i anëtares së zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga AAK, Rabije Sallahi - zëvendësimi i anëtares së dorëhequr Hafize Sallahi;
2. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja Inauguruese e Kuvendit të Komunës;
3. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
4. Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;
5. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;

6. Raporti Financiar për periudhën janar-shtator 2021; dhe
7. Propozim Vendimi për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2022.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Fillimisht ua përkujtoj anëtarëve të zgjedhur të Kuvendit të Komunës së duhet të deklaroni pasurinë në Agjencinë, në afatin e përcaktuar ligjor duke filluar nga marrja e mandatit, përndryshe mund keni pasoja juridike. Anëtarët e rizgjedhur e bëjnë vetëm deklarimin e rregullt të pasurisë në mars nga 1-31 mars të vitit kalendarik.
Para se të fillojmë me rendin e punës, kemi kërkuar nga sekretaria që t'ua dërgoj një email për përcaktimin e shefave të grupeve parlamentare(ShGP), në mënyrë që të dimë se ku të adresohemi në raste të caktuara. Andaj kërkoj fillimisht nga subjektet politike që të deklarohen për shefat e grupeve parlamentare, duke filluar nga subjektit me i madh politik PDK, pastaj shkojmë të subjektet tjera politike.

**z. Rrustem Zenuni:** Nga PDK, Shef i GP është caktuar anëtarja, Fitore Vishi.
**z. Adnan Reka:** Para se të deklarohemi për shefat e GP, fillimisht shfrytëzoj rastin t'i përshëndes të gjithë kolegët dhe t'iu uroj marrjen e mandatit të ri, urime edhe atyre që kanë rimarrë mandatin. LVV e propozon për Shef të GP, anëtarin, Agim Mani.
**z. Besnik Salihu:** Nga LDK, e propozoj Shef i GP, anëtaren, Ardita Rrahmani.
**znj. Rabije Sallahi:** Nga AAK, është caktuar anëtari, Ekrem Livoreka.
Kryesuesi i Kuvendit, Në emër të subjektit politik, NISMA fjalën e merr në KK, Agim Çaka.
Atëherë, shefat e GP u caktuan, kalojmë në shqyrtimin e pikave sipas radhës:

**1.** Betimi solemn i anëtares së zgjedhur të Kuvendit të Komunës nga AAK, Rabije Sallahi - zëvendësimi i anëtares së dorëhequr Hafize Sallahi;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Kërkoj nga znj. Rabije Sallahi të lexon tekstin e Betimit solemn të përcaktuar si në LVL, ndërkaq në shenjë respekti, i ftojmë të gjithë të pranishmit të ngitemi në këmbë.

Teksti i betimit solemn u lexua nga znj. Rabije Sallahi, si vijon:

**Unë Rabije Sallahi, "Betohem (ose deklaroj solemnisht) se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e më ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të komunës së Kaçanikut, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë, Betohem.**

**Kryesuesi i Kuvendit:** Urime Rabije, punë të mbarë në aktivitetin e KK, ndërkaq konstatoj;
**Ndryshim plotësimet e përbërjes së Kuvendit të Komunës të Legjislaturës së gjashtë (6) të KK të zgjedhur me 17 tetor 2021 / Lënda: 01Nr. 60/01-38147/21.**

Në bazë të Vendimit KQZ Nr. 3472 të datës 17.12.2021, anëtarja e dorëhequr nga AAK Hafize Sallahi, zëvendësohet me kandidatin e radhës nga subjekti politik i AAK, Rabije Sallahi. Nga kjo datë i realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të KK, dhe i merr të gjitha përgjegjësitë të cilat i takojnë si të anëtarëve tjerë të KK, ndërkaq pushon të jetë anëtar sipas dispozitave të nenit 37.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040.

**2.** Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Materialin e keni marrë, nëse ka kush diçka lë të urdhëroj:

**z. Agim Çaka,** Nuk e di sa është problematike kjo unë kam parë gabime teknike dhe drejtshkrimore në procesverbal.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Procesverbali është i korrektuar, mundet të ketë ndonjë gabim, apo ka mundësi që ju të jeni gabim. Meqë nuk ka kush diçka, atëherë procesverbalin e mbledhjes së kaluar të KK me vërejtjet e Agim Çaka, e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua me vetëm 1 abstenim, Rabije Sallahi, për shkak së e njëjta nuk ka qenë pjesë e KK. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës e,

**APROVON**

**Procesverbalin nga mbledhja inauguruese e Kuvendit të Komunës të datës 08 dhjetor 2021/ Lënda: 01Nr. 60/01-36366/2021.**

**Pyetje dhe Kërkesa**

**z. Adnan Reka:** Si kërkesë të parë të kësaj legjislature dua të theksoj ndërtesën e sallës se KK, e të mos shfrytëzohet, improvizohet ndonjë zyre e objektit te komunës për sallë të Kuvendit Komunal, si institucioni me i rëndësishëm në nivel të komunës. Kjo zyre e improvizuar nuk i bënë nderë askujt në gjendjen që është, sepse nuk plotëson as kriteret themelore të qenit sallë e një Kuvendi Komunal.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Keni të drejtë, pajtohem plotësisht me këtë kërkesë, një projekt ishte i gatshëm që nga viti i kaluar, por të njëjtin na i hoqën MAPL. Kërkoj edhe nga ju dhe kushdo që ka mundësi se ne jemi të gatshëm të fillojmë me procedurat. Mjetet të gatshme nga buxhet nuk kemi, por me bashkëfinancim me MAPL mund të zhvillojmë procedurat, sepse kjo sallë nuk i plotëson kushtet për një mbledhje të KK, nuk kemi as foltore, kështu që e mbështesë këtë kërkesë.

**znj. Ardita Rrahmani:** Në emër të LDK, kërkoj që pikat: Propozim Vendimin për formimin e KPF dhe Propozim Vendimin për formimin e Komitetit për Komunitete, për ti shtyrë për mbledhjen vijuese, pasi që për momentin, nuk është në mbledhje z. Betim Shala, ose t'i shqyrtojmë në fund këto dy pikë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Para miratimit të rendit të punës mund të jepni propozime nëse keni diçka, për ndryshim apo shtyrje të ndonjë pikë, mandej KK vendosë. Rendi i punës u miratua, mos prezenca e Betim Shala nuk mendoj se paraqet problem në këto pika, për shkak së janë propozime që i takojnë grupeve parlamentare dhe ekziston një formulë për formimin e tyre. Kur të kalojmë të pikat, mundesh me marrë fjalën dhe me dhënë propozime.
Pyetje dhe kërkesa tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikën e tretë;

**3.** Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sipas LVL, janë dy komitetet obliguese të cilat duhet t'i themeloj KK në fillim të legjislaturës së tij. 1. Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe 2. Komiteti për komunitete. Sipas Rregullores për themelimin e komiteteve të obliguara thuhet që KK që kanë numër 21-31 anëtarë, numri i anëtarëve të KPF është 7. Përbërja KK në komunën tonë maksimumin e KPF e ka 7 anëtarë. Sipas rregullores në fjalë, thuhet së përbërja duhet të reflektoj numrin e ulëseve në KK që kanë fituar në zgjedhje dhe kuotën gjinore sipas Ligjit për barazi gjinore. Sipas Propozim Vendimit, KPF përfaqësohet me 7 anëtarë me kryesuesin e KK, i cili vjen sipas detyrës zyrtare Përfaqësimi është: PDK me 2 anëtarë + kryesuesi i KK, LVV me 2 anëtarë, LDK me 1 anëtar dhe AAK me 1 anëtar. E hapi diskutimin para se me kaluar në propozime konkrete:
**znj. Ardita Rrahmani:** Në emër të LDK, kërkoj 5 min. pauzë për konsultim.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Për çështjen e kërkesës për pauzë, nuk ka problem. Nëse ndonjë grup tjetër ka nevojë për konsultime, lë të urdhërojnë. Pas pauzës 5 minuta kryesuesi vazhdoj me punimet e mbledhjes. Shkojmë me propozimet duke filluar nga PDK.

**z. Rrustem Zenuni:** Nga PDK për anëtarë të KPF i propozojmë anëtarët:
1. Kadri Krivenjeva dhe 2. Fitore Vishi.

**z. Adnan Reka:** Nga LVV për anëtarë të KPF i propozojmë anëtarët:
1. Agim Mani dhe 2. Kadrije Lika-Troni.

**znj. Arlinda Rakoci-Raka:** Nga LDK për anëtare të KPF e propozojmë, Ardita Rrahmani.
**z. Ekrem Livoreka:** Nga AAK për anëtare të KPF e propozojmë, Rabije Sallahi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozimet të cilat dolën i shtroj në votim për aprovim. Propozimet u aprovuan me shumicën e votave Për, Kundër ishte Raif Kasa, Abstenoj Agim Çaka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), në përbërje:**

1. **Kemal Murseli PDK Kryesues sipas detyrës zyrtare**
2. **Kadri Krivenjeva PDK anëtar**
3. **Fitore Vishi PDK anëtare**
4. **Agim Mani LVV anëtar**
5. **Kadrije Lika-Troni LVV anëtare**
6. **Ardita Rrahmani LDK anëtare**
7. **Rabije Sallahi AAK anëtare. / Lënda: 01Nr. 60/01-38152/21.**

**4.** Propozim Vendimi për formimin e Komitetit për Komunitete;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Komiteti për Komunitete është një komitet i cili fillimisht është paraparë në komunat ku jetojnë komunitetet pakicë, pastaj nuk kanë munduar me u ndarë komunat të cilat nuk kanë etnitete, atëherë është përcaktuar që në komunat që nuk kanë pakica, numri i anëtarëve të këtij komiteti të jetë 5 anëtarë, sipas rregullores për formimin e komiteteve të përhershme në komunë. Ne duhet t'i propozojmë 3 anëtarë nga KK dhe 2 anëtarë nga OJQ dhe grupet tjera të interesit. Përbërja e Komitetit për Komunitete në komunën tonë duhet të jetë prej 5 anëtarëve. Nëse nuk ka kush diçka, shkojmë me

propozimet konkrete të përfaqësuesve të KK në këtë komitet, pastaj 2 emra nga OJQ i jep Kryetari i Komunës të cilat besoj se ia janë dërguar OJQ.

**z. Adnan Reka:** Nëse ju thoni se 2 anëtarë duhet të jenë nga jashtë, unë nuk e ndajë mendimin me ju. Sa e di unë se vetëm 1 anëtar duhet të jenë nga jashtë, e jo siç po pretendoni ju që 2 anëtarë të jenë nga jashtë. Këtë çështje e lexova në Udhëzimin Administrativ që rregullon këtë çështje.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Ne me herët kemi pasur edhe me tepër anëtarë nga OJQ në këtë komitet, por numri ka qenë më i madh i përbërjes, ndërkaq tani numri është i kufizuar në 5 anëtarë. Ne nga KK e reduktuam numrin e anëtarëve në mënyrë që të përfshijmë OJQ me tepër për më iu dhënë hapësirë përfaqësimit të tyre, për shkak se ata nuk po kanë mundësi të përfaqësimit. Megjithatë e shtrojmë në votim që të vendosim për përfaqësimin në këtë komitet të KK dhe përfaqësuesve nga jashtë.

**z. Adnan Reka:** Ne kemi komunitet në komunën e Kaçanikut, ndoshta është mirë me ju ofruar përfaqësimin në këtë komitet. Ne e dimë realitetin, unë thashë është mirë me ua ofruar këtë pozitë, nëse nuk kemi komunitete, atëherë të përfaqësohet një anëtarë nga OJQ dhe 4 anëtarë nga KK.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë nuk e di se ka ndonjë komunitet i regjistruar si etnitet. Qëllimi i jonë ka qenë me i përfaqësua sa me shumë OJQ, nëse ju e ndani mendimin për përfaqësim me të madh të KK, neve nuk ka problem në këtë drejtim.

**z. Adnan Reka:** Unë e kam fjalën që mos të bëjmë shkelje të procedurave ligjore dhe administrative.

**Kryesuesi i KK:** Jo shkelje ligjore nuk bëjmë, anëtarët e komitetit për komunitete mund t'i marrim krejt nga jashtë, kjo nuk na pengon asgjë, por nëse jeni që të jetë vetëm 1 anëtarë nga OJQ e lëmë ashtu, unë e pranoj këtë propozim. Atëherë nëse nuk ka kush diçka, përbërja e këtij komiteti është 5 anëtarë, 4 anëtarë të jenë nga KK dhe 1 anëtarë nga jashtë. Kërkoj nga grupet parlamentare t'i japin emrat për 4 anëtarë nga KK. Kërkojmë nga grupet më të mëdha politike të japin nga 1 emër për anëtar të komitetit për komunitete duke filluar nga grupi me i madh politik- PDK.

**znj. Fitore Vishi:** Përshëndetje për të gjithë, nga grupi parlamentar i PDK e propozojmë për anëtare të Komitetit për Komunitete, Lejla Muhaxheri-Çaka, për arsye të kuotës gjinore.
**Kryesuesi i kuvendit:** Harrova të sqaroj së edhe këtu duhet të kemi kuotën gjinore, atëherë vazhdojmë me propozimet e subjekteve tjera politike.

**z. Agim Mani:** Faleminderit kryesues, përshëndetje për të gjithë, nga LVV e propozojmë për anëtar të Komitetit për Komunitete Adnan Reka.

**znj. Ardita Rrahmani:** Nga LDK, e propozojmë për anëtar të Komitetit për Komunitete Betim Shala.

**znj. Rabije Sallahi:** Nga AAK e propozojmë për anëtar të komitetit për Komunitete, Ekrem Livoreka.

**Kryesuesi i Kuvendit**: Me kuotën gjinore nuk jemi në rregull, nga OJQ nuk ka anëtare femër të propozuar. Kërkojmë nga dy grupet politike LVV apo LDK që njëra prej tyre të japin kandidatë femër, për shkak se vendimi mund të na kthehet nga MAPL. Kërkoj mirëkuptimin e juaj, përndryshe na e kthejnë MAPL dhe duhet të merremi dy herë me këtë punë.
**z. Agim Mani:** Ne LVV e tërheqim propozimin për anëtarin Adnan Reka, ndërkaq e propozojmë për anëtare të Komitetit për Komunitete, Arta Avdiu.
**Kryetari i Komunës:** Nga OJQ, theksoj se kemi menduar për 2 emra, mirëpo po e anëtarësojmë në këtë komision anëtarin e parë të propozuar, e ai është, Arben Thaqi.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Propozimet të cilat u dhanë i shtroj në votim për aprovim dhe u aprovuan me shumicën e votave për, kundër votë nuk ka, abstenoj Agim Çaka. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për formimin e Komitetit për Komunitete, në përbërje prej 5 anëtarëve, si vijon:**

1. **Lejla Muhaxheri- Çaka, PDK anëtare**
2. **Arta Advdiu LVV anëtare**
3. **Betim Shala LDK anëtar**
4. **Ekrem Livoreka AAK anëtar**
5. **Arben Thaqi OJQ/ shoqëria civile anëtar.**

Kryesuesi i këtij komiteti zgjidhet nga radhët e anëtarëve të këtij komiteti.
**Lënda: 01Nr. 60/01-38151/21.**

**5.** Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Plani i punës së KK hartohet në vija të trasha nga sekretaria e KK. Plani është orientues e nuk do të thotë së nuk ndryshohet dhe plotësohet sipas kërkesave dhe nevojave të cilat paraqitën gjatë vitit në periudha të caktuara. Megjithatë duhet formohet një komision për të shtuar edhe pikë tjera nëpër mbledhje të caktuara për zhvillimin e punës së KK për vitin 2022. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë shkojmë me propozime konkrete duke filluar nga subjekti politik me i madh- PDK.
**znj. Fitore Vishi:** Nga PDK e propozojmë për anëtar të komisionit, Fatmir Bunjaku.
**z. Agim Mani:** Nga LVV e propozojmë për anëtar të komisionit, Adnan Reka.
**Ekrem Livoreka:** Nga AAK nuk kemi kandidat për anëtar të komisionit.
**znj. Ardita Rrahmani:** Nga LDK e propozojmë për anëtare të komisionit, Arlinda Rakoci-Raka,
Nga NISMA, Kryesuesi i Kuvendit e propozoj në këtë komision, Agim Çaka.
Kryetari i Komunë: Besim Ilazi, Nga Ekzekutivi i komunës e propozoj për anëtare të komisionit, Makfire Malsiu.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Meqë u bënë 6 anëtarë, atëherë nga PDK jam unë, kështu që e tërheqim propozimin për kandidatin nga PDK, Fatmir Bunjaku.

Propozimet të cilat dolën u shtruan në votim për aprovim dhe u aprovuan me votat Për, të anëtarëve të KK, me përjashtim të Raif Kasa i cili votoj kundër. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**

**Për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, në përbërje:**

1. **Kemal Murseli, PDK Kryesues i komisionit;**
2. **Adnan Reka LVV anëtar**
3. **Arlinda Rakoci-Raka LDK anëtar**
4. **Agim Çaka NISMA anëtar**
5. **Makfire Malsiu Ekzekutivi i komunës anëtar.**

**Lënda: 01Nr. 60/01-38141/21.**

**6.** Raporti Financiar për periudhën Janar-Shtator 2021;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Raportet financiare janë 3, 6 , 9 mujore dhe vjetore për debat në KK. Raportet financiare nuk votohen, raporti është proceduar për KK për njoftim, por jepen sqarime për grumbullimin e mjeteve dhe shpërndarjen e tyre nga ana e ekzekutivit. Nëse ka kush diçka, e hapi diskutimin;

**z. Adnan Reka:** Përveç debatit të Raporti Nëntëmujor Financiar thash se, Raporti Nëntëmujor Financiar tregon qartë se kemi të bëjmë me shpërndarje tejet të dobët të buxhetit komunal, për faktin se 71.17 % shpenzohet për paga dhe mëditje, ndërsa për Investime Kapitale vetëm 17.77 %, ndërkaq për subvencione dhe transfere 2.85 %.
Ndër të tjera theksova se, në vitin 2021 kishte 154.562€, ndërsa në vitin 2020 kishte vetëm 58.394 €, që i bie gati 3 herë me tepër subvencione në vitin elektoral 2021.
LVV uroi që subvencione dhe transfere të ketë edhe me tepër se kaq, por të mos keqpërdoret paraja publike për t'i joshur votuesit përmes subvencioneve gjatë fushatave elektorale.

**Kryesuesi Kuvendit:** Për sqarime të nevojshme të raportit, fjalën e ka drejtori i drejtorisë së Financave, Bahri Selimi.

**z. Bahri Selimi:** Faleminderit kryesues, përshëndetje të gjithëve, shfrytëzoj rastin fillimisht t'iu uroj marrjen e mandatit të gjithë anëtarëve të KK. Fillimisht po jap sqarim së për shkak të mosfunksionimit të KK për shkak të zgjedhjeve lokale, raportin 9 mujor e sjellim tani në muajin dhjetor të këtij viti, përndryshe po të kishte funksionuar KK ky raport ishte shqyrtuar në përfundim të shtatorit. Kur jemi të buxheti 2021 është një shpenzim mjaft i mirë i buxhetit, 58.33% realizimi i buxhetit, përndryshe 6.42% me e lartë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Para se me dhënë përgjigje, nëse e keni shikuar raportin e të HVK janë realizuar me përformancë të lartë, e kemi tejkaluar planin qysh në muajin shtator, të hyrat direkte. Çdo euro e inkasuar pas muajit shtator e deri në dhjetor paraqet tejkalim të HVK, ku falë zyrtarëve komunal, ekzekutivit të komunës, sidomos të inkasimit të tatimi në pronë dhe në tokë – lejet e ndërtimit, taksat e ndryshme për inkasimin e TP, taksat e ndryshme të trashëgimisë te sektori i kadastrit dhe urbanizmit. Komuna ka treguar performancë të lartë të HVK- përformanca me e lartë e arritur ndonjëherë. Sa i përket shqetësimeve të Adnanit, të Investimet Kapitale, është mirë të

sqarohemi se ju i referoheni një shumë 17.77% të investimit, investime kapitale janë 35.38%.
**z. Adnan Reka:** Unë iu referova investimeve kapitale për tërë vitin 2021 që është 17.17% e jo për 9 muaj të vitit 2021. investimet kapitale, pagat dhe mëditjet kanë këto përqindje të cilat i ceka. Për paga dhe mëditje janë 71.17%, investime kapitale janë 17.17%, subvencione dhe transfere, 2.85%.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Raporti është për 9 muaj, e jo për tërë vitin, duhet pasur parasysh këtë fakt.

**z. Bahri Selimi:** Nëse shihni buxhetin në total, e shihni të tabela me nr. 3, totali është 17.17%, por jo në pjesëmarrje të përgjithshme të buxhetit, përndryshe Adnan është shpenzuar afër 36% e buxhetit në këtë program apo për 82% më shumë së vitin e kaluar të periudhës së njëjtë, për shkak së ishte vit pandemie, d.m.th. ecuria nuk është e keqe. Të subvencionet, si buxhet nuk ka shumë dallim me vitin 2020 si ndarje, por si shpenzim ka. Subvencionimi është të sektori i kulturës ku janë subvencionuar për shkak të përshpejtimit të HVK të cilat i përmenda më herët, ka pasur mjete për subvencione dhe janë subvencionuar nga të HVK. Janë subvencionuar të gjitha aktivitetet kulturore sportive, OJQ e ndryshme, ndërsa në vitin e kaluar ka pasur ngecje, me vonë janë shpenzuar shumica e subvencioneve, për shkak të mbylljes së vendit, masave të pandemisë nuk kanë zhvilluar aktivitete kulturore e sportive as OJQ, do të thotë së nuk ka pasur shumë aktivitete.

**z. Adnan Reka:** Në vitin 2020 edhe nëse i shikojmë ndihmat momentale 1500€ në vitin 2021,së bashku bëjnë 11.000€. SHKA që po i përmend, në vitin e kaluar nuk iu keni dhënë subvencione, në rregull, mirëpo kemi një vitin jo pandemie 2019 prapë diferenca janë mjaftë të mëdha. Nëse i referohemi tingujt e vendlindjes, 6.500€ euro i kanë marrë këtë vit, SHKA Gryka e Kaçanikut 3.900€ dhe u kanë vit pandemie 2021, ose nëse i referohemi 2019, diferencat janë 1.300€, 1.500€, por jo 6.500€ diferenca jashtëzakonisht të mëdha. Kjo po tregon qartë që viti elektoral e jo pandemia ka qenë ai që i ka shtyrë me iu dhënë edhe ndihma çasti edhe para në dorë edhe kush ka pasur me ndërtuar shtëpi apo ndonjë nevojë tjetër.

**z. Bahri Selimi:** Për shkak së viti 2020 ka qenë vit pandemie, ka pasur ngecje në të gjitha sferat në sektorin e kulturës. Në vitin 2021 i kemi subvencionuar me kohë klubet sportive, ekonomitë familjare, sepse janë dëmtuar shumë, kështu që u janë ndarë mjete nga Zyra e Kryetarit, 1.500 € ndihmat momentale.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi:** Sa i përket subvencioneve Adnan, shifrën të cilën po e sheh, dua të tregoj së vitin e kaluar i kemi ndarë 181 sera, ndërkaq sivjet 177 sera. Të SHKA sa për informacion, këtyre dy grupeve iu kanë ndarë mjetet e barabarta, por nëse nuk të kujtohet këtë vit e kemi bërë një thirrje publike për bashkatdhetarët, dhe janë ndarë 2.000€ shtesë. Nga thirrje publike ka përfituar një shoqëri 6.500€, për ndryshe të gjitha janë të njëjta me vitin paraprak, me përjashtim të shpenzimeve të transportit. Të subvencionet, këtë vit ka pasur mundësi që të ketë më tepër subvencionim në vlera, sepse në vitin e kaluar i kemi ndarë 100.000 € dhe i kemi dhënë në formë tjetër, ndërkaq këtë vit nja 5 apo 6 mijë euro janë ndarë për skamnorët dhe të gjithë janë me emra dhe mundesh me verifikuar se a ka ndikuar kjo në procesin e fushatës elektorale.

**z. Adnan Reka:** Të SHKA, Tingujt e Vendlindjes, në një periudhë jo pandemie që është dashur të kenë aktivitete shumë me shumë që kanë mundur të kenë, por fatkeqësisht nuk kanë pasur, se ju nuk iu keni dhënë mjete. Unë nuk po dua të spekuloj se a kanë pasur apo jo mjete. Dallimet kanë qenë shumë të mëdha në vitin 2020, së po shihen kategoritë të cilat nuk iu keni dhënë, por iu keni thënë se do t'iu japim në vitin 2021 të gjitha. Në vitin 2020 nuk ka pasur zgjedhje, viti 2021 ka pasur zgjedhje dhe iu kanë dhënë mjete, kujt iu kanë nevojitur, për shtëpia etj. Mirë që iu keni dhënë, shumë mirë keni bërë, unë nuk jam kundër subvencioneve, por jo me i shfrytëzua vitet elektorale si viti 2017 e njëjta situatë ka ndodhë, sepse në vitin 2017 ka pasur subvencione me shumë së çdo vit tjetër, kjo nuk është në rregull.

**Kryesuesi i Kuvendit**: Nëse i krahasojmë vitet e ndarjes së subvencioneve si tërësi, ju e dini që në vitin 2020 janë ndarë 100.000 € subvencione nga KK dhe ato mjete këtu nuk figurojnë hiq. Janë 58.000€ në vitin 2020, ato 100.000€ kanë rrjedhur nga pagat dhe mëditjet. Nëse ia shtojmë edhe ato mjete, bëjnë 158.000 në vitin e kaluar, e për sivjet mbesin 154.000€. Nëse e bëjmë një krahasim si tërësi, ti e din së ke qenë anëtar i KK, në vitin e kaluar janë ndarë 100.000€ ndihma për shkak të pandemisë. Sivjet nuk është vit pandemie, janë subvencionuar disa kategori tjera. Vjet ka qenë vit pandemie, janë rezervuar disa kategori nuk janë subvencionuar, si klubet sportive, SHKA etj. Nëse e bënë këtë dalim e ke të lehtë me gjetur mundësinë.

**z. Adnan Reka:** Është e vërtetë së në vitin 2020 janë ndarë 100.000€ dhe shumica e atyre mjeteve kanë shkuar për dezinfektim të shkollave, miell që iu ka dhënë skamnorëve, por shumica e mjeteve kanë shkuar për dezinfektues, unë mundem t' ua sjellë edhe raportin për këtë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Pavarësisht ku kanë shkuar mjetet, nuk iu kanë dhënë SHKA, por janë dhënë për dezinfektim. Sivjet janë dhënë mjete sa me pak për dezinfektim, ndërkaq me shumë mjetet për aktivitete kulturore, se janë hapur aktivitetet, kështu që krahasimi është ky.

**z. Adnan Reka:** Unë i bëra tre krahasime, vitin 2019 kur nuk ishte vit pandemie, viti 2020 ku ishte vit pandemie, dhe viti 2021 që ishte vit elektoral.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Në vitin elektoral po thoni se shpenzimet kapitale janë shumë të vogla. Nëse ka qenë vit elektoral viti 2021, atëherë me shpenzime kapitale është dashur me ecur përpara.

**Kryetari i Komunës-Besim Ilazi :** Adnan, ne e kemi një letër përpara dhe t'i po e sheh sesi janë ndarë mjetet, po e sheh që nga DAK janë ndarë 91.000 €, dhe po e sheh qartë se si janë ndarë nëpër kategori të caktuara, dhe shuma tjetër është 54.000€ që janë ndarë për 177 sera. Unë nuk e di se ku po dyshon për këto të dhëna që po i sheh dhe ti e din së shpërndarja bëhet me thirrje publike, dhe në thirrje publike nuk e ka diferencën që tre vjet dhe nëse i ke shikuar ndarjet janë gati të njëjta me përjashtim të Tingujt e vendlindjes që është ndarë për diasporën me thirrje publike, ku iu kanë shtuar edhe 3.000€ apo 3.500€ dhe nën 1, unë kam thënë së ne nuk ndërhyjmë në pjesën e drejtësisë. Nuk është mirë me i dezinformuar qytetarët me iu thënë janë shpenzuar 6.000€. Janë ndarë 6.000€, por nuk janë shpenzuar 2.000€. Tre herë janë ndarë nga ministria që e financon projektin nga 2.000€ por nuk janë shpenzuar të gjitha. Është mirë kur të kesh shifrën e saktë së është një

përfaqësues i tyre i cili është menaxher, kështu kur të kesh shifrën e saktë shumën, 6.500€ ia argumenton si kanë shkuar. Mos u thirrur në atë nëse ministria i ka ndarë 6.500 €, janë dhënë mjetet, por nuk janë shpenzuar, mjetet e ngelura janë kthyer ministrisë.

**z. Adnan Reka:** Unë kryetar iu pyeta edhe për banesën sociale, që na keni thënë së është në krime ekonomike. Unë jam anëtar i KK dhe takohemi përsëri këtu me vendime dhe me shifra me të sakta edhe me centë, me dokumente zyrtare, për ti argumentuar edhe më saktë. Këto që jam duke i thënë, nuk janë mjete të ministrisë, këto janë shpenzime të cilat na i kemi ndarë mjetet nga viti 2017 pak nga pak. Në mbledhjen tjetër unë i sjellë të dhënat e sakta.

**Kryetari i Komunës:** A bënë me u sqarua anëtarëve të KK sa mjete janë ndarë nga KK, se nuk kanë me dalë shifra, 6.000€, të lutem, Unë mundem me thënë, me shumë se vlera e kontraktuar po, por jo me tepër së 6.500€.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Adnan, nëse ke edhe diçka me thënë, së kjo është jashtë çdo rregulloreje. Kur të marrësh fjalën, thuaje çka ke me thënë deri në fund, përfundoje dhe e merr tjetri fjalën. Është mirë më iu përmbajtur rregullores.

**z. Agim Çaka:** Kërkoj nga kryesuesi i KK që t'ua krijon hapësirën edhe anëtarëve tjerë, me marrë fjalën, sepse diskutimi për këtë pikë deri me tani kaloj në bashkëbisedim. Secili anëtari KK duhet me marrë fjalën dhe me thënë atë që donë me thënë, pastaj me marrë përgjigjen nga zyrtari i autorizuar. Të ky buxhet, unë jam anëtar i ri i KK dhe nuk kam pasur qasje, mendoj që drejtori duhet me na i dhënë sqarimet e nevojshme se ku ka pasur shpenzime jo korrekte, ku ka çaluar realizimi i buxhetit. Unë nuk kam mundur ta lexoj në tërësi raportin, tema e cila u diskutuar deri me tani, nuk duhet të kalojnë në bashkëbisedim, sepse shumica e anëtarëve të KK nuk janë profesionist dhe nuk i kuptojnë terminologjitë profesionale, prandaj drejtori duhet të jetë më konkret. Të objekti i banimit social, duhet me sqarua, sa mjete janë ndarë nga qeveria, a janë shpenzuar të gjitha ato mjete apo jo. Nëse nuk janë shpenzuar të gjitha, duhet të sqarohet, sa mjete janë kthyer në ministri. Gjithashtu duhet sqaruar sa mjete i ka dhënë komuna, a janë shpenzuar apo nuk janë shpenzuar të gjitha mjetet që i ka ndarë komuna.

**z. Bahri Selimi:** Të objekti i banimit social mundeni me kërkua sqarim specifik edhe në ndonjë mbledhje tjetër. Të subvencionet u sqaruam, jemi këtu me dhënë sqarime dhe shquhemi për transparencë së jemi një ndër komunat që jemi bukur transparente. Përveç raportit, shumë detaje i shpalosin analitikat për çdo shpenzim që ndodhë. E tha edhe kryetari, nëse është nevoja me emra i japim edhe përfituesit individual të subvencioneve, për pako ushqimore apo ndërtimin e shtëpive. Janë 4 elemente këtu që i kanë rritur subvencionet në krahasim me vitin e kaluar. Viti i kaluar e thamë se ka qenë bukur pasiv në ushtrimin e aktiviteteve të ndryshme, në anën tjetër ishte një fillimi i vitit 2021 ku gjithçka realizohet me mjete financiare. Sa i përket sektorit të arsimit, ju e dini Adnan sa është zhvilluar procesi mësimor në krahasim me këtë vit 23.237€ janë shpenzuar për transportin e nxënësve .

**Kryesuesi i Kuvendit:** Diskutime të tjera nuk ka, raporti nuk del në votim. Në bazë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës, u,

**Njoftua**

**Me Raportin Financiar për periudhën janar-shtator 2021/ Lënda: 01Nr. 400/01-38144/21.**

**7.** Propozim Vendimi për aprovimin e listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2022;

**Kryesuesi i Kuvendit:** Sipas Ligjit të ri për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, si dhe rregullores, komunat janë të obliguara që për pronat që mendojnë t'i japin në shfrytëzim në vitin paraprak, atëherë janë të obliguara që deri me 31 dhjetor të miratojnë në KK listën e pronave, pastaj nga komisioni i cili formohet nga KK hapet mundësia e zhvillimit të procedurave përmes shpalljeve publike për të interesuarit për pronat të cilat do të jepen në shfrytëzim. Nëse nuk miratojmë listën në këtë vit, në vitin vijues nuk mund të japim asnjë pronë komunale në shfrytëzim. Materialin e keni marrë, arsyeja e komunës duhet të jetë interesi publik i komunës, pronësia e komunës dëshmohet me certifikata të pronës. Nëse ka kush diçka në këtë pikë, e hapi diskutimin:

**z. Betim Shala:** Të këto prona komunale nuk parashihet destinimi i tyre me PZHK. Neni 5 pika 2 e Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale, ashtu siç e potencuat edhe ju kryesues, thuhet së; qëllimi i shfrytëzimit të pronës së paluajtshme e komunës të jetë e harmonizuar me dokumentet e planifikimit hapësinor. Këto prona duhet të jenë të harmonizuara me PZHK, ndërkaq unë nuk po e shoh se a janë të gjitha këto prona të përshtatura me PZHK i cili është në fuqi, apo nuk janë.

**Kryesuesi i Kuvendit:** Unë edhe me herët e pata këtë çështje, para së me ia kaluar fjalën kryetarit, besoj se ti e din që PZHK është nga 2010, që 11 vite në fuqi. PZHK mund të ndryshohen pas 8 viteve dhe PZHK i riu është në hartim e sipër, e di që ju si zyrtar për urbanizëm dhe shumë zyrtarë tjerë kanë punuar në hartimin e atij plani, megjithatë këto prona nuk mund të epën në shfrytëzim, nëse nuk përputhën me PZHK, por si mundësi për me nxënë vitin për të hapur tema për pronat që janë në harmoni me PZHK, besoj së duhet të aprovohet në KK dhe në momentin që aprovohet në KK nuk do të thotë që këto prona janë dhënë në shfrytëzim, por krijohet mundësia që të epën në shfrytëzim, mandej komisioni i cili themelohet nga KK bashkë me ekzekutivin e kanë për obligim që në momentin që vendosin për thirrje publike apo ankand publik, të kenë parasysh edhe përshtatshmërinë e shfrytëzimit të këtyre pronave me PZHK. Nëse arsyetohet PZHK para se me dalë këto prona në thirrje publike për të interesuarit, duhet të jetë në harmoni me PZHK të ri. Nëse nuk del PZHK ri deri kur të dalin këto prona në thirrje publike, atëherë duhet të harmonizohen me PZHK aktual që është në fuqi. Mendoj së komisioni duhet t'i ketë parasysh këto çështje. Nuk është mirë të ngecet kjo çështje sot këtu, pasi që pastaj gjatë tërë vitit nuk kemi me pasur mundësi me diskutuar këtu për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim.

**z. Betim Shala:** Unë mendoj së këto prona komunale nuk janë në harmoni me PZHK. PZHK duhet me i paraprirë vendimit të KK e jo vendimi i KK me i paraprirë PZHK. Pronat e cilat kanë me u dhënë në shfrytëzim për destinimin e caktuar, si p.sh. zonat industriale që nuk janë me PZHK, duhet të hiqen nga lista. Unë mendoj kështu.

**Kryesuesi i Kuvendit**: Unë nuk e kam sjellë, hartuar vet, propozim vendimin e ka sjell DUKMM, kur të dalin këto në thirrje publike, disa prej tyre të cilat mund të dalin apo të

gjitha, atëherë duhet të harmonizohen më PZHK që është në fuqi, por si procedurë nuk është mirë të ngecet këtu, se pastaj gjatë tërë vitit nuk mundem me dhënë prona komunale në shfrytëzim.

**Kryetari i Komunës- Besim Ilazi,** Është e vërtetë se disa prona kanë hyrë në listë që nuk janë me PZHK, si e dini edhe ti ke qenë pjesë që keni punuar në PZHK, po shpresojmë në 3 mujorin e parë me realizua. Nëse nuk gaboj, drafti i parë ka dalë, shpresoj të marrim edhe miratimi nga ministria që parashihen. Në PZHK të ri janë të parapara këto prona të cilat i kemi proceduar dhe po shpresojmë që do ta kemi PZHK dhe të procedojmë në mënyrë që mos të presim edhe 7-8 muaj tjerë për ti ecur këto procedura. Në momentin që nuk kemi arritur qe të bëjmë PZHK këto janë të paarsyeshme edhe me i procedua, dhe nuk do bëjmë një gjë të tillë me i procedua për me i udhëhequr procedurat. Këto prona hapen në momentin që na kemi ndonjë ofertues. Mund të ndodhë që mos të epën asnjë prej tyre në vitin 2022 nëse nuk e shohim seriozitetin e kompanie. Procedurat udhëhiqen përmes ankandin dhe të njëjtat përsëri vijnë në KK për miratim. Kjo ka qenë arsyeja që i kemi proceduar këto prona, së paku mos të jemi pengesë e kompanive të cilat donë me investuar në komunën e Kaçanikut.

**Kryesuesi t Kuvendit:** Vendimi pas miratimit shkon në shqyrtim të ligjshmërisë, edhe nëse nuk kalon së nuk është i harmonizuar me PZHK, përsëri na kthehet në rishqyrtim. Kjo është një mundësi për të proceduar në vitin vijues, për me iu krijua mundësi investitorëve dhe të interesuarve për të marrë prona komunale në shfrytëzim, por gjithnjë duke qenë pronat komunale në harmoni me PZHK.
Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim Propozim Vendimin dhe i njëjti u aprovua me 14 votë Për, 6 votë Kundër ( 4 anëtarët nga LDK, Raif Kasa nga LVV dhe Agim Çaka nga NISMA), Abstenuan 7 anëtarë nga LVV. Në saje të kësaj del konstatimi del së Kuvendi i Komunës mori këtë:

**VENDIM**
**Për aprovimin e Listës së veçantë të pronave komunale të cilat planifikohen të jepen në shfrytëzim në vitin 2022 / Lënda: 01Nr. 104/02-38073/21.**

Për fund Kryesuesi i Kuvendit ua përkujtoj edhe një herë anëtarëve të KK të cilët janë zgjedhur dhe e kanë marrë mandatin, **për të pasur parasysh çështjen e deklarimit të pasurisë në afatin e përcaktuar ligjor prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së mandatit 08 dhjetorit 2021, ndërsa anëtarët e KK të cilët janë rizgjedhur, duhet bëjnë deklarimin e rregullt vjetor nga 1-31 mars 2022.**

**Pasi jeni pajisur me Laptop, ju njoftoj së tani e tutje, materialet ua dërgojmë në formë elektronike, në emaile zyrtare të cilat do t'iu hapen nga zyrtari i IT.**

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, kështu që konstatoj mbledhjen e përfunduar në ora 12:20. Deri në fund të mbledhjes ishin të gjithë anëtarët.

| | |
|---|---|
| Procesmbajtës | Kryesuesi i Kuvendit |
| Makfire Malsiu | Kemal Murseli |

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU

Komuna e Kacanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01Nr. 60/01-1567/22
Kaçanik, 14. 01. 2022

Në bazë të nenit 40.2(d) të Ligjit Nr. 03L-/040- Për Vetëqeverisjen Lokale(Gazeta Zyrtare Nr. 28 /04 Qershor 2008 e Republikës së Kosovës), të neneve 34.5 dhe 36 lidhur më nenet 40, 41 dhe 42 të Statutit të Komunës, të nenit 15(c) lidhur me nenin 24 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Komisioni për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022, në mbledhjen e mbajtur me 14.01.2021,

**PROPOZON**

Që Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur me ____________ të merr këtë:

## VENDIM
## PËR APROVIMIN E PLANIT TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2022

1. Me këtë Vendim, APROVOHET Plani i Punës së Kuvendit të Komunës së Kaçanikut për vitin 2022.

2. Plani vjetor i lartcekur në pikën 1. të këtij vendimi, përmban numrin e mbledhjeve pikat, temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e kuvendit, vendi dhe ora e mbajtjes, kryesimi i mbledhjeve si dhe numrin e mbledhjeve që do të kompensohen për aktivitetin e kuvendit dhe trupave punuese të tij për vitin 2022.

3. Kuvendi i Komunës Kaçanik, në vitin 2022, planifikon që t'i mbajë gjithsej 12 mbledhje të rregullta. Çdo mbledhje e kuvendit të komunës i paraprinë mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa.

4. Mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës, do të mbahen sipas këtij plani të punës:

# PLANI I MBLEDHJEVE TË KUVENDIT
# PËR VITIN 2022

| Nr. | Mbledhjet | Periudha Kohore | Vendi i mbajtjes | Ora | Rendi i Punës | Kryesimi i mbledhjeve |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 |
| **01.** | Mbledhja e I | Javën e fundit të muajit janar | Katin i III Salla e KK | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës e datës 29.12.2021;<br>2. Plani i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022;<br>3. Plani i punës së Ekzekutivit të Komunës për vitin 2022;<br>4. Raporti i punës së Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, për vitin 2021;<br>5. Propozim Vendimi për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB;<br>6. Informatë e drejtorisë së Arsimit për përfundimin e gjysmë vjetorit të parë të vitit shkollor, 2021/2022;<br>7. Propozim Vendimi për ndarjen e masës drusore të konfiskuar në vitin 2021, shkollave të komunës;<br>8. Kërkesa e Asociacionit të Komunave të Kosovës- AAK, për emërimin e delegatëve në Kuvendin e AAK. | Kryesuesi i KK |
| **02.** | Mbledhja e II | Javën e fundit të muajit shkurt | - " - | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I, e Rregullt e Kuvendit të Komunës për vitin 2022;<br>2. Plan i punës së Komitetit për komunitete për vitin 2022;<br>3. Propozim Vendimi për formimin e ndonjë komiteti- nga Komitetet tjera;<br>4. Propozim Vendimi për bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2021, në vitin 2022;<br>5. Raporti i punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2021;<br>6. Informatë e Zyrës së personelit për | -"- |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 7. Plani i punës së KKSB për vitin 2022;<br>8. Raportit financiar i komunës për periudhën janar-dhjetor 2021;<br>9. Raporti i punës së Auditorit të brendshëm për vitin 2021.<br>10. Plani i punës së Komitetit konsultativ për personat me aftësi të kufizuara, për aktivitetin e zhvilluar në vitin 2022.<br>11. Propozim Vendimi për themelimin e Komisionit komunal të Aksionarëve për KRM "Pastërtia" SH.A-Njësia në Kaçanik;<br>12.Propozim Vendimi për formimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Komunale (NPK) " Stacioni i Autobusëve" SH.A- Kaçanik. | | |
| **03.** | Mbledhja e III | Javën e fundit të muajit mars | -“- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e II-të e rregullt e Kuvendit të Komunës;<br>2. Informatë mbi zbatimin e Ligjit kundër duhanit në territorin e komunës së Kaçanikut;<br>3. Raporti i Shtabit Emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut për vitin 2021;<br>4. Informatë për zbatimin e planit të integritetit;<br>5. Shqyrtimi i ndonjë propozim rregulloreje apo propozim vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës. | | -“- |
| **04.** | Mbledhja e IV | Javën e fundit të muajit prill | -“- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e III-të e rregullt e Kuvendit të Komunës;<br>2. Raporti tremujor financiar i komunës, janar – mars 2022;<br>3. Shqyrtimi i ndonjë propozim rregulloreje apo propozim vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës. | | -“- |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **05.** | Mbledhja e V | Javën e fundit të muajit maj | -“- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IV-të e rregullt e Kuvendit të Komunës;<br>2. Informatë mbi Qarkoren e I (Parë) buxhetore të ministrisë së Financave;<br>3. Informatë për aktivitetin e komiteteve funksionale të kuvendit;<br>4. Informatë për zbatimin e Rregullores për mbrojtjen e drejtave të fëmijëve.<br>5. Shqyrtimi i ndonjë, propozim rregulloreje apo propozim vendimi të propozuara nga Ekzekutivi i Komunës. | | -“- |
| **06.** | Mbledhja e VI | Javën e fundit të muajit qershor | -“- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e V-të e rregullt e Kuvendit të Komunës;<br>2. Korniza afatmesme buxhetore e komunës (KAB) për vitet 2023-2025;<br>3. Propozim Vendimi për rishikimin e buxhetit te komunës për vitin 2022;<br>4. Shqyrtimi i Raportit (Informatës) rreth aktiviteteve të KKSB-së;<br>5. Shqyrtimi i ndonjë propozim rregulloreje apo propozim vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës;<br>6. Informatë për realizimin e planit të prokurimit.<br>7. Informatë për përformancën e komunës për vitin 2021.<br>8. Plani komunal për menaxhimin e mbeturinave për vitet 2022-2026. | | -“- |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **07.** | Mbledhja e VII | Javën e dytë të muajit korrik | -"- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VI-të e rregullt e Kuvendit të Komunës;<br>2. Raporti gjashtëmujor financiar, janar - qershor 2022;<br>3. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të përgjithshëm për Komunën e Kaçanikut për vitin 2021;<br>4. Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve sipas raportit të Auditorit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021;<br>5. Shqyrtimi i ndonjë propozim rregulloreje apo propozim vendimi të propozuar nga ekzekutivi i komunës;<br>6. Informatë e Drejtorisë së Arsimit, për përfundimin e vitit shkollor 2021/2022,<br>7. Raporti i Shtabit emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut. | -"- |
| **08.** | Mbledhja e VIII | Java e fundit e muajit korrik | | | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VII-të e rregullt e Kuvendit të Komunës;<br>2. Informatë për realizimin e buxhetit të komunës për vitin 2022;<br>3. Shqyrtimi i ndonjë propozim rregulloreje apo propozim vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i komunës;<br>4. Informatë mbi përfundimin e fushatës së korrje-shirjeve;<br>5. Informatë për aktivitetin e Zyrës për barazi gjinore. | |
| **09.** | Mbledhja e IX | Javën e fundit të muajit shtator | -"- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VIII e rregullt e Kuvendit të Komunës;<br>2. Shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit të komunës për vitin 2023 dhe projeksionet për vitet 2024-2025;<br>3. Propozim vendimi për aprovimin e normave tatimore të tatimit në pronë për vitin 2023;<br>4. Raporti i zbatimit të rekomandimeve të raportit të Auditorit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021;<br>5. Shqyrtimi i ndonjë propozim vendimi të | "- |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | propozuar nga Ekzekutivi i Komunës;<br>6. Informatë për fillimin e vitit te ri shkollor, 2022-2023. | |
| 10. | Mbledhja e X | Javën e fundit të muajit tetor | -"- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IX e rregullt e Kuvendit të Komunës;<br>2. Shqyrtimi i Raportit financiar të komunës, janar- shtator 2022;<br>3. Shqyrtimi i ndonjë propozim rregulloreje apo propozim vendimi të propozuar nga ekzekutivi komunës;<br>4. Raporti i Shtabit emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut. | -" |
| 11. | Mbledhja e XI | Javën e fundit të muajit nëntor | -"- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e X e rregullt e Kuvendit të komunës;<br>2. Shqyrtimi i ndonjë propozim rregulloreje apo propozim vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i Komunës;<br>3. Informatë e DUKMM për procesin e legalizimit të objekteve të ndërtimit;<br>4. Informatë e Kryetarit të Komunës mbi gjendjen e përgjithshme të komunës;<br>5. Informatë e drejtorisë se Bujqësisë për të mbjellat vjeshtore; | -"- |
| 12. | Mbledhja e XII | Periudha; 19 - 23 dhjetor 2022 | -"- | 11:00 | 1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XI e rregullt e kuvendit të komunës;<br>2. Shqyrtimi i ndonjë propozim vendimi të propozuar nga Ekzekutivi i komunës;<br>3. Informatë e KKSB për aktivitetin e zhvilluar në vitin 2022;<br>4. Informatë për zbatimin e planit vjetor të Prokurimit publik për vitin 2022.<br>5. Informatë për funksionimin e këshillave lokale;<br>6. Raporti i Shtabit emergjent për parandalimin e Covid-19 në Komunën e Kaçanikut. | -"- |

**4.** Mbledhjet e kuvendit të komunës caktohen nga Kryesuesi i kuvendit, në konsultim me kryetarin e komunës.

**4.1.** Minimumi i mbledhjeve të rregullta të kuvendit të komunës për një vit kalendarik është 10 mbledhje të rregullta, prej tyre se paku 5 mbledhje të rregullta duhet të mbahen në gjashtëmujorin e parë të vitit kalendarik, sipas LVL neni 43.2.

**4.2.** Maksimumi i mbledhjeve të kuvendit të komunës me karakter pune, me pagesë për një vit kalendarik është 12 Mbledhje.

5. Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjatë vitit 2022, i ka paraparë me Planin e punës me i mbajtur gjithsej 12 mbledhje me pagesë.

**5.1.** Kuvendi i komunës mund të mbajë edhe mbledhje tjera më shumë së 12 mbledhje të rregullta, por nga mbledhja e 13 të gjitha mbledhjet e kuvendit të komunës me karakter pune, e rregullt apo jo e rregullt, do të jenë pa pagesë.

**5.2.** Aktiviteti i zhvilluar i kuvendit të komunës është barrë e buxhetit të komunës, për vitin 2022 nga Programi buxhetor, Zyra e Kuvendin e Komunës, për; Paga dhe Mëditje dhe për: Mallra dhe Shërbime;

**5.3.** Shpenzimet: Për Paga dhe Mëditje do të paguhen:

**5.3.1.** Paga mujore e Kryesuesit të Kuvendit për 12 muaj,

**5.3.2.** Paushall mujor për anëtarët e KK sipas akteve në fuqi,

**5.3.3.** Kompensimi i mëditjeve për 12 mbledhje të kuvendit për 26 anëtarë të Kuvendit, për pjesëmarrje në mbledhje,

**5.3.4.** Kompensimi i mëditjeve për 12 mbledhje të KPF për 6 anëtarë, për pjesëmarrje në mbledhje,

**5.3.5.** Kompensimi i mëditjeve për 10 mbledhje të Komitetit për komunitete për 5 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje,

**5.3.6.** Kompensimi i mëditjeve për 6 mbledhje të ndonjë komiteti- nga komitetet tjera, për 5 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje.

**5.3.7.** Kompensimi i mëditjeve për 6 mbledhje të Komitetit konsultative për persona me aftësi të kufizuara , për 7 anëtarë për pjesëmarrje në mbledhje.

**5.3.8.** Nëse mungon anëtari në mbledhje të kuvendit apo të komiteteve, heqja e mëditjes do të bëhet në pajtim me aktet në fuqi.

**5.4.** Shpenzimet për mallra dhe shërbime janë në shumë me buxhetin e komunës të vitit 2022, ku përfshihen;

**5.4.1.** Shpenzime të furnizimit për zyre dhe blerje tjera mallra e shërbime;

**5.4.2.** Shpenzime për dreka zyrtare, ku përfshihen: shpenzimet e bufesë për zyrën e kryesuesit, shpenzimet për ujë dhe pije për mbledhje të kuvendit dhe komitete të kuvendit, shpenzimet për debatin publik të organizuar me qytetarë të komunës, për buxhetin e komunës për vitin 2023 dhe projeksionet për vitin 2024-2025 (ujë dhe pije ), organizuar nga kryesuesi i kuvendit,

5.4.3. Shpenzime të tjera; udhëtime zyrtare jashtë vendit, informimit publik, marketing, botime e publikime dhe shpenzime të përfaqësimit.

**6.** Të gjitha mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës do të mbahen vetëm ditëve të punës.

**6.1.** Materialet që i adresohen kuvendit të komunës, janë kryesisht çështje të propozuara nga Ekzekutivi i komunës, e që kalojnë procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të KPF-s, dhe të njëjtat, me rekomandim të KPF-s i kalojnë kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim apo në procedurë të mëtejme.

**6.1.** Njoftimet për mbledhje të kuvendit të komunës bëhen publike.

**6.2.** Materialet për mbledhjet e rregullta të kuvendit të komunës iu dërgohen anëtarëve të kuvendit të komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes.

**6.3.** Njoftimet dhe materiali i mbledhjes i dërgohet edhe kryetarit të komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

7. Ky Plan pune i mbledhjeve të kuvendit të komunës, është plan orientues edhe për mbledhjet e KPF, të cilat mbledhje do të mbahen se paku 3 ditë para mbledhjeve të kuvendit të komunës, me të gjitha pikat e propozuara, me përjashtim të procesverbalit të mbledhjeve të kuvendit, planeve dhe raporteve të trupave punuese të KK.
8. Kuvendi i komunës Kaçanik, në muajin shtator do të mbajë Dëgjim publik me qytetarë për; Propozim-Buxhetin e komunës për vitin 2023 dhe projeksionet për vitet: 2024-2025, para se të aprovohet buxheti në kuvend.

**9.** Të gjitha mbledhjet e rregullta të KK do të jenë hapura për; qytetarë, media dhe për çdo të interesuar tjetër.

**9.1.** Nëse ndonjë mbledhje e rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura, atëherë për këtë duhet të vendosë kuvendi i komunës.

**9.2.** Nëse mbledhja mbahet me dyer të hapura, në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarë të komunës, mediat dhe të interesuar të tjerë, në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

**10**. Kuvendi i komunës për gjatë muajit gusht, do të jetë në pushim vjetor.

**10.1.** Për fillimin dhe mbarimin e pushimit, kuvendi i komunës do të njoftohet paraprakisht.

**10.2.** Për gjatë pushimit (muajin gusht) nuk planifikohet mbajtja e ndonjë mbledhje përveç nëse paraqitet ndonjë çështje eventuale, atëherë nuk përjashtohet mundësia të mblidhet kuvendi i komunës.

**11.** Plani i përcaktuar i kuvendit të komunës për vitin 2022, është orientues e nuk do të thotë se nuk pëson ndryshime varësisht nga kërkesat dhe nevojat që paraqitën.

**12.** Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr.01/2017- për procedurën e hartimit dhe publikimin e akteve të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli
_______________

REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK
REPUBLIKA KOSOVA

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova**
**Republic of Kosovo**

**Komuna e Kaçanikut**
**Opština Kacanik**
**Municipal Kacanik**

# PLANI I PUNËS SË EKZEKUTIVIT TË KOMUNËS

2022

**K a ç a n i k, 2022**

Hartoi: Zyra e Kryetarit

Shqyrton dhe miraton: Kuvendi i Komunës

## 1. Misioni

"*Ofrimi i mbështetjes për të gjithë qytetarët, investimet kapitale dhe shërbimet administrative të përditshme duke siguruar koordinim dhe bashkëpunim midis Ministrive, Komunës, Drejtorive, Zyrave, Shoqërisë Civile dhe Partnerëve tjerë në funksion të ofrimit të shërbimeve efikase ndaj qytetarëve të Kaçanikut".*

## 2. Vizioni

*"Përsosmëri në ofrimin e shërbimeve, përfshirjen e qytetarëve, barazinë, llogaridhënien, qëndrueshmërinë, punën në grup, transparencën, sigurinë në punë dhe respektin e ndërsjellë".*

Ekzekutivi i Komunës, duke u bazuar në Statutin e Komunës së Kaçanikut, Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe Rregulloret e punës si dhe aktet e tjera ligjore, ka hartuar Planin e Punës për vitin 2022 me qëllim të përmbushjes së synimeve dhe objektivave të parashtruara për këtë periudhë kohore. Në këtë plan janë paraparë të gjitha aktivitetet që do të zhvillohen gjatë vitit 2022, të cilat aktivitete janë bashkërenduar në koordinim të plotë me Kryetarin e Komunës. Suksesi i zbatimit të këtij plani do të varet nga udhëheqësit që menaxhojnë drejtoritë apo sektorët e veçantë për të cilët ata janë përgjegjës.

Ekzekutivi i komunës, aktivitetin e vet e zhvillon përmes 9 drejtorive komunale dhe njësive e zyrave të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me zyrën e kryetarit të komunës:

- **Drejtoria e Administratës së Përgjithshme**
- **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale**
- **Drejtoria e Arsimit**
- **Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave**
- **Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

● **Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës**

● **Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë**

**Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

**Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik**

● **Zyra e Personelit**

● **Zyra e Informimit**

● **Zyra e Prokurimit**

● **Zyra për Teknologji Informative**

● **Zyra për Barazi Gjinore**

● **Zyra Ligjore**

**Zyra e Kuvendit**

**Zyra e Inspektoratit**

Ekzekutivi i Komunës gjatë vitit 2022 do të fokusohet në këto aktivitetet kyçe:

Vazhdim i efikasitetit dhe cilësisë në punë

Vazhdim i ushtrimit të përgjegjësive dhe menaxhimit në pajtueshmëri të plotë me ligjet të cilat rregullojnë përgjegjësitë e komunës dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës dhe Rregulloret e Punës.

Rregullimi i infrastrukturës shkollore dhe shëndetësore

Ngritja e cilësisë në arsim dhe shërbimeve shëndetësore

Ofrimin e kushteve themelore për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik

Koordinimi i aktiviteteve me donatorë të brendshëm dhe të jashtëm

Përcjellja dhe menaxhimi i realizimit të projekteve

Përkushtim i shtuar në plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe ushtrimin e përgjegjësive nga autoritetet lokale sa më afër qytetarëve

Thellimi i transparencës dhe llogaridhënia

Bashkëpunim ndërkomunal

Bashkëpunim i ngushtë me nivelet qendrore

Bashkëpunimi me Asociacionin e Komunave të Kosovës

Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare

Bashkëpunimi me organizata joqeveritare lokale dhe qendrore

Shënimi i ngjarjeve të rëndësishme si përvjetorët e betejave, Ditës së Çlirimit të Komunës, Ditës së dëshmorëve, Përvjetorit të Pavarësisë, aktivitete rinore etj.

Vërejtje: Realizimi i të gjitha aktiviteteve të planifikuara, varet nga situata me Pandeminë COVID dhe masat e rekomanduara nga institucionet shëndetësore.

## Zyra e Personelit

| Aktivitetet e planifikuara | Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve | | Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara | Partnerët implementues të aktiviteteve |
|---|---|---|---|---|
| | Koha | Vendi | | |
| **1. Menaxhimi dhe koordinimi i punëve sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për zyrtarët publikë dhe rregulloreve për procedurat përkatëse të nxjerra në bazë të këtij ligji.** | | | | |
| Zhvillimi i procedurave të rekrutimit sipas LZP-së nr. 06/L-114 dhe rregulloreve përkatëse për pranimin e zyrtarëve publikë si dhe Planit të personelit për vitin 2022. Zhvillimi i procedurave në shërbimin civil bëhet përmes sistemit informativ për menaxhimin e burimeve njerëzore (SIMBNJ-së) ndërsa, për nëpunësit e shërbimit publik dhe nëpunësit teknik dhe mbështetës konkursi hapet përmes portalit për rekrutim elektronik por procedura zhvillohet në formë fizike<br><br>1.1 Zhvillimi i procedurës së emërimit të nëpunësve civil të ri dhe periudhës provuese | janar – dhjetor 2022 | Zyra e personelit | Zhvillimi i procedurave te rekrutimit sipas planit te personelit. Informimi me kohë, i drejtë dhe i saktë për vendet e lira të punës, Përzgjedhja e kandidatëve sipas meritës. | Zyra e personelit, MAP-i,<br><br>Zyrtari më i lart administrativ (Kryetari i Komunës) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1.2 Hartimin e planit të personelit për të gjithë zyrtarët publik sipas nevojave të drejtorive përkatëse, në harmoni me planin e ndarjes buxhetore te shpenzimeve dhe dorëzimi i tij në DMZP- MPB.<br><br>1.3 Zhvillimi procedurës së vlerësimit të periudhës provuese dhe vlerësimit vjetor i zyrtarëve publikë përmes SIMBNJ-së<br><br>1.4 Zhvillimi i procedurës së ndërprerje së marrëdhënies së punës<br>1.5 Zbatimi i Rregullores se pushimeve .<br><br>1.6 Ofrimi i këshillave profesionale lidhur me çështjet e personelit për udhëheqësin më të lartë administrativ (Kryetarin e Komunës), menaxherët drejtues si dhe përkrahje administrative për komisionet e formuara për zhvillimin e procedurave që kanë të bëjnë me çështjet e personelit. | dhjetor<br><br>janar | | Emërimi i kandidatëve te ri.<br><br>Sipas këtij plani , përcaktohen qartë objektivat për çështjet e personelit, përshkruhet gjendja ekzistuese e personelit dhe planifikimi i ri si dhe ndryshimet tjera te mundshme të personelit<br><br>Vlerësimi vjetor i zyrtarëve publike. Përpilimi i raportit përmbledhës të vlerësimeve të nëpunësve civil dhe dorëzimi në DMZP-MPB. | Udhëheqësi i personelit ,Kryetari i Komunës, Drejtorët e Drejtorive komunale<br><br>Zyra e personelit , drejtoret e drejtorive komunale. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1.7 Regjistrimi i te gjithë nëpunësve civil ne sistemin e kartelave<br><br>1.8 Zhvillimi i procedurës se përshkrimit të vendeve të punës, klasifikimit të vendeve të punës dhe rregulloreve tjera për çështjet e personelit | janar-2022<br><br>janar-dhjetor<br><br>janar – dhjetor<br><br>janar-dhjetor | | Evidentimi i pushimeve vjetore, mjekësore, te lehonisë, pa pagesë etj.<br><br>- Kryerja e detyrave sipas Ligjit për zyrtarët publikë të dhe rregulloreve përkatëse siç është Procedura e ankesave dhe procedura disiplinore si dhe procedura tjera.<br><br>Zbatimi i orarit të punës nga të gjithë nëpunësit civil.<br><br>Menaxhimi dhe evidentimi i hyrje-daljeve ne sistemin e kartelave<br><br>Zbatimi i procedurave sipas rregulloreve ne fuqi | Zyra e personelit,Kryetari i Komunës, Drejtoritë komunale.<br><br>Stafi ekzekutiv i Komunës, zyra e personelit dhe zyrtaret |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | janar<br>dhjetor | | | |
| **2. Zbatimi i ligjit Nr. 03/LP-147 për pagat e nëpunësve civil** | | | | |
| 2.1 Përgatitja e vendimeve për stafin, përcjellja e ndryshimeve për sistemimin e tyre në sistemin e pagave, mbajtja e listave te pagave të nënshkruara ne dosje elektronike si dhe kopje fizike .<br><br>2.2 Bartja e listave të pagave dhe raportit financiar nga sistemi i pagave dhe përcjellja e listave të zyrtaret financiar . | janar-<br>Dhjetor | Zyra e personelit | Sistemimi i punëtorëve në sistemin e pagave sipas legjislacionit në fuqi. Mbikëqyrja e inkorporimit te ndryshimeve ne sistemin e pagave | Kryetari i Komunës, Udhëheqësi i personelit, zyrtaret e personelit |
| **3. Mirëmbajtja e dhe plotësimi i dosjeve të personelit ne kopje fizike dhe elektronike** | | | | |
| 3.1 Kompletimi i dosjeve si dhe ruajtja e tyre në mënyrë shumë të sigurt dhe vend te sigurt.<br><br>3.2 Përditësimi me të dhëna të reja të personelit në sistemin e informimit të burimeve njerëzore (SIMBNJ) | janar – dhjetor 2022 | Zyra e personelit<br><br>Zyra e personelit | Ruajtja e dokumenteve fizike personale të të gjithë zyrtareve publikë.<br><br>Evidentimi dhe ruajtja e tërë dokumentacionit personal të punëtorëve në SIMBNJ (Sist. elektronik) | Zyra e personelit<br><br>Zyra e personelit dhe MPB |
| **4 Raportimi i rregullt në organet qendrore lidhur me çështjet e personelit** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 4.1 Raportimi lidhur me të punësuarit në administratë, arsim dhe shëndetësi për DMZP-në –MPB-në<br><br>4.2 Përgjigje në ankesat e paraqitura në KPMSHCK<br><br>4.3 Raporte pune për Kryetarin e komunës<br><br>4.4.Raport vjetor i punës për Kuvendin Komunes<br><br>4.4 raport për vlerësimin e nevojave për trajnime për Ministritë e linjes<br><br>4.5 Raporte për çështjet e personelit ne organet qendrore | Raporte tre mujore<br><br>Brenda afateve të kërkuara<br><br>Raporte javore, mujore dhe vjetore<br><br>janar 2022 | Zyra e personelit | | Zyra e personelit<br><br>Zyra e personelit |

## Zyra e Informimit

| Nr. | Objektivat e planit të veprimit | Aktivitetet e planit të transparencës | Njësia apo personi përgjegjës për publikimin e dokumenteve dhe aktiviteteve të komunës | Vendi i mbajtjes së aktiviteteve | Afatet ligjore për shpallje publike të dokumenteve dhe aktiviteteve të organeve komunës. |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Mbledhje të hapura të Kuvendit të Komunës dhe Komiteteve** | Njoftimi për mbledhje të rregullta të Kuvendit Komunal dhe Komiteteve në:<br>Web faqen zyrtare<br>Në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës<br>Rrjete sociale | Sekretaria e Kuvendit përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjeve për mbledhjet e kuvendit dhe tri ditë për mbledhjet e komiteteve | Salla e Kuvendit Komunal / Komiteteve | Shtatë ditë para mbajtjes së mbledhjeve për mbledhjet e kuvendit dhe tri ditë për mbledhjet e komiteteve |
| 2 | **Përgatitja dhe publikimi i informatave nga mbledhjet e Kuvendit dhe Komiteteve** | Përgatitja e informatave pas çdo mbledhje të kuvendit dhe komiteteve për mediat e shkruara dhe elektronike si dhe rrjetet sociale | Zyra për Informim | | |
| 3 | **Takimet e kryetarit me publikun** | Kryetari i Komunës së Kaçanikut mban së paku dy takime publike për çështje të interesit të përgjithshëm | Zyra e Kryetarit, përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe | Salla e kuvendit | Njoftimi 2 javë para mbajtjes |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | atë në web faqen zyrtare, rrjete sociale dhe në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës | | |
| **4** | **Konsultimet me publikun** | Komuna e Kaçanikut organizon konsultime të ndryshme që janë në interes të qytetarëve dhe që lidhen me buxhetin komunal, zhvillimin ekonomik lokal | Sekretaria Kryetarit, përmes zyrtarit për komunikim me publikun njofton qytetarët së paku dy javë përpara mbajtjes së takimeve publike si dhe dëgjimeve të ndryshme edhe atë në web faqen zyrtare, në vendet më të frekuentuara brenda territorit të Komunës dhe rrjetet sociale | Kuvendi komunal | Njoftimi 2 javë para mbajtjes |
| **5** | **1. Raportet/Informatat për media të Kryetarit dhe drejtorive Komunale** | Kryetari i Komunës së Kaçanikut dhe drejtorët e drejtorive komunale publikon raportet/informatat, të paktën dy herë brenda vitit. | Zyra për Informim Publik publikon raportet/informatat në web faqen zyrtare dhe faqen zyrtare të Komunës në rrjetin social Facebook. | | |
| **6** | **Raportet/Informatat për media të Kryesuesit** | Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Kaçanikut publikon raportin/informatën të paktën dy herë brenda vitit | Zyra e Kuvendit përgatit raportin/informatën dhe i përcjell zyrës së informimit për publikim në web faqen zyrtare dhe faqen zyrtare të komunës në rrjetin social Facebook | | |
| **7** | **Takimet e Kryetarit me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë** | Kryetari i Komunës së Kaçanikut, në kuadër të kompetencave të tij, realizon | Debatet e tilla i organizon Kabineti i Kryetarit, duke | Zyra e Kryetarit ose salla | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | takime në formë debati me qytetarë, OJQ, grupe të interesit dhe gazetarë | siguruar hapësirë të mjaftueshme për pjesëmarrje. | tjera alternative | |
| **8** | **E drejta e qasjes në dokumente publike** | Për të qenë sa më transparent ndaj publikut, Komuna e Kaçanikut, bënë pranimin dhe shqyrtimin fillestar të kërkesave për qasje në dokumente publike, të aprovuara nga organet e Komunës dhe i adreson ato në pajtueshmëri me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike. | Zyrtari përgjegjës për qasje në dokumentet publike | | 7-15 ditë |
| **9** | **Kërkesat për informim, iniciativat qytetare dhe peticionet** | Subjekti fizik ose juridik ka të drejtë të parashtrojë kërkesë në Komunën e Kaçanikut, për realizimin e iniciativave qytetare dhe peticioneve për çështje që janë në përgjegjësi të organeve komunale. | Pas diskutimit në Kuvendin e Komunës, Kryetari, Drejtoria, Njësia apo zyrtari për komunikim me qytetarë, jo më vonë se 15 ditë nga dita e shqyrtimit, njofton me shkrim parashtruesin e kërkesës ose peticionit. | | 15 ditë |
| **10** | **Publikimi i akteve komunale** | Të gjitha vendimet, rregulloret dhe dokumentet tjera të Kuvendit Komunal të Kaçanikut publikimi i të cilave nuk kufizohet sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, bëhen publike dhe të qasshme për publikun | Sekretaria e Kuvendit përmes Zyrës për Informim Publik dhe njësia e IT-së, publikon aktet komunale në web faqen zyrtare | | |
| | | | | | |
| **11** | **Publikimi i të gjitha raporteve, vendimeve, rregulloreve, buxhetit komunal, projekteve kapitale,** | Të gjitha raportet, vendimet, buxheti komunal, projektet kapitale, projektet e | Kabineti i Kryetarit përmes Zyrës për Informim Publik dhe | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **projekteve të planifikuara, tenderëve, etj. të zyrës së kryetarit, dhe shërbimeve tjera të komunës** | planifikuara, tenderët etj, nga zyra e kryetarit dhe shërbimet e tjera të komunës do të bëhen publike dhe të qasshme për qytetarët | Njësia e IT-së publikon aktet komunale në web faqen zyrtare | | |
| **12** | **Mirëmbajtja dhe freskimi i web faqes zyrtare** | Web faqja zyrtare e Komunës së Kaçanikut freskohet me lajme e informacione nga aktivitetet e përditshme të ekzekutivit dhe vendimmarrjes, si dhe materiale tjera publike sipas udhëzimit Administrativ Nr. 03/2020 | Përgjegjëse për këtë është Zyra për Informim e Komunës së Kaçanikut. | | |
| | | | | | |
| **13** | **Transmetimi i seancave të Kuvendit Komunal** | Transmetimi i seancës së kuvendit komunal përmes video ingjizimit, i cili më pas transmetohet në faqen zyrtare të komunës si dhe në rrjetin social | Përgjegjëse për këtë është Njësia e IT-së e Komunës së Kaçanikut. | | |
| **14** | **Shfrytëzimi i rrjeteve sociale** | Komuna e Kaçanikut ka të hapur faqen zyrtare në rrjetin social Facebook, ku publikohen të gjitha informatat e ekzekutivit dhe vendimmarrësve sikurse edhe dokumente të tjera. | Përgjegjëse për këtë faqe është Zyra për Informim Publik dhe njësia e IT-së | | |
| | | | | | |
| **15** | **Përgatitja, shtypja dhe shpërndarja e Vjetarit të komunës** | Informimi i qytetarëve për aktivitetet vjetore, raportet dhe vendimet e komunës si dhe projektet më të rëndësishme të komunës | Përgjegjëse për këtë është Zyra për Informim dhe njësia e IT-së e Komunës së Kaçanikut. | | |
| **16** | **Qasje e lehtë e qytetarëve në shërbimet digjitale** | Komuna e Kaçanikut ka mundësuar aplikimin online për certifikatat e gjendjes civile, në | Përgjegjëse është Drejtoria e Administratës përmes Zyrës për | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | web faqen zyrtare të Komunës. Poashtu për të lehtësuar proceduarat janë publikuar edhe disa udhëzues për dokumente të ndryshme të gjendjes civile, kadastrit etj. | Informim Publik dhe Njësia e IT-së | | |
| **17** | **Prokurimi transparent** | Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Departamenti i Prokurimit i dërgon me kohë të gjitha njoftimet për kontrata, njoftimet për dhënie të kontratave, njoftimet për konkurse të projektimit dhe njoftimet për vazhdim të afatit. | Përgjegjës për publikim të tyre ne web faqe është Departamenti i Prokurimit, Zyra për Informim njësia e IT-së e komunës. | | Sipas afateve ligjore |
| **18** | **Transparenca në procedurat e punësimit** | Komuna e Kaçanikut, përkatësisht Zyra e Personelit është përgjegjëse për publikim në web faqe të konkurseve, njoftimeve për përzgjedhjen e kandidatëve, njoftimeve për anulim të konkurseve, rishpalljen apo vazhdimin e afateve, avancimet brenda institucionit si dhe aplikacionet për punësim. | Zyra e Personelit në bashkëpunim me Zyrën për Informim Publik dhe njësia e IT-së | | Sipas afateve ligjore |

**Zyra për Teknologji Informative**

| | Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve | | Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara | Partnerët implementues të aktiviteteve |
|---|---|---|---|---|
| | Koha | Vendi | | |
| **1. Mirëmbajtja e Teknologjisë Informative dhe menaxhimi i tyre** | | | | |
| - Mirëmbajtja e teknologjisë informative, instalim te programeve, programim etj. | janar – dhjetor 2022 | Ne komunë dhe te gjitha institucionet e komunës | Intervenime me kohë me qëllim qe zyrtarët mos te ngecin mbrapa për shkaqe teknike te teknologjisë informative | |
| **2. Fibër optik ne komune dhe shtrirja e rrjetit qeveritare neper institucionet e komunës** | | | | |
| Shkolla, Zyret e gj.c etj.. | | Komuna | Kyçja e rrjetit qeveritare neper institucioneve te komunës me qellim te sigurisë me te madhe te bëzeve te dhënave = | |
| **3. Server për shënime ( Centralizim te shënimeve ne Komune)** | | | | |
| Centralizmin e shënimeve ne Komune ne nje Server | janar – dhjetor 2022 | Komuna | Qëllimi i këtij file server është qe ti centralizojmë shënimet me një server dhe ta bëjmë një bekap ne ministri sepse ne raste fatkeqësie te dhënat e zyrtareve te jene me te sigurta. | |
| **4. Strategjia për Qeverisje Elektronike** | | | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Implementimi i programeve te strategjisë elektronike... | janar – dhjetor 2022 | Komune | Administrate efikase.<br><br>Qeverisja elektronike është ofrimi i shërbimeve të institucioneve qeveritare përmes teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ndaj qytetarëve, bizneseve dhe kategorive të tjera. | |
| **5. Të tjera** | | | | |
| Mirëmbajta e ueb faqes se Komunës dhe INTRANETI | janar – dhjetore 2022 | | Mirëmbajtja e ueb faqes se Komunës | |

## Zyra e Prokurimit

| Aktivitetet e planifikuara | Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve | | Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara | Partnerët implementues të aktiviteteve |
|---|---|---|---|---|
| | **Koha** | **Vendi** | | |

| 1. RAPORTIMET | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 1.1 Përgatitja e raporteve sipas udhëzimeve të KRPP-së lidhur me kontratat e realizuara gjatë vitit 2021<br>1.2 Përgatitja dhe dorëzimi i Planifikimit të Prokurirmit per vitin 2022<br>1.3 Pregatitja dhe percjellja e lëdëve për Auditim sipas planit të paraparë nga Auditori i brenshëm dhe Zyra Kombtare e Auditimit<br>1.4 Pregatitja e vendimeve në rast kërkesave pë rishqyrtim dhe përcjellja e vendimeve OE.<br>1.5 Pregatitje dhe përfaqsimi i AK në rast të kërkesave nga OE për Rishqyrtim pranë OSHP-së. | janar- 2022 | Kaçanik | Rritja e transparencës dhe llogaridhënies | KRPP, ZKA,dhe Njisit kërkuese. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | janar-dhjetorë | | | KRPP, ZKA,OSHP dhe Njisit kërkuese. |
| | janar-dhjetorë | | | KRPP, ZKA,OSHP dhe Njisit kërkuese. |

| 2. UDHËHEQJA E PROCEDURAVE PËR FURNIZIME | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 2.1 Përgatitja e DT dhe publikimi i tenderëve për furnizime sipas kërkesave të njësive kërkuese dhe të planit të punës të ekzekutivit të komunës për vitin 2022,Publikimi përmes KRPP , Formimi i komisioneve vlersuese, Plotësimi dhe përcjellja e Form. Standard për OE | Shkurt-Tetor 2022 | Komuna | Funksionalitetin dhe efikasitetin e administratë komunale, arsimit dhe shëndetësisë. | Për implementimin e këtyre projekteve janë Autoriteti Kontraktues dhe OE (Operatorët Ekonomik) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| pjesëmarrës në njoftimet për kontrata. | | | | |
| 2. UDHËHEQJA E PROCEDURAVE PËR SHËRBIME | | | | |
| 2.1 Përgatitja e DT dhe publikimi i tenderëve për shërbime sipas kërkesave të njësive kërkuese dhe sipas planit të punës të ekzekutivit të komunës për vitin 2022, Publikimi përmes KRPP , Formimi i komisioneve vlersuese ,Plotësimi dhe përcjellja e Form. Standard për OE pjesëmarrës në njoftimet për kontrata. | shkurt-tetor 2022 | Komuna | Funksionalizimi i shërbimeve për administratë komunale, arsimit dhe shëndetësisë. | Për implementimin e këtyre projekteve janë Autoriteti Kontraktues dhe OE (Operatorët Ekonomik) |
| **3.** UDHËHEQJA E PROCEDURAVE PËR INVESTIMET KAPITALE | | | | |
| 3.1 Përgatitja e DT dhe publikimi i tenderëve sipas listës së miratuar ne Kuvendin e Komunës, projektet kapitale për vitin 2022, Publikimi përmes KRPP , Formimi i komisioneve vlersuese Plotësimi dhe përcjellja e Form. Standard për OE | shkurt – shtator 2022 | Komuna | Krijimi i kushteve më të mira për të gjithë banorët e komunës sonë. | Për implementimin e këtyre projekteve janë Autoriteti Kontraktues dhe OE (Operatorët Ekonomik) |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| pjesëmarrës në njoftimet për kontrata. | | | | |
| 4. TRAJNIMI I STAFIT | | | | |
| 4.1 Trajnimet e obligueshme në fushën e Prokurimit | qershor-dhjetor 2022 | Prishtinë | Avancimi dhe profesionalizimi i stafit. | IKAP, KRPP |

## Zyra për Komunitete dhe Kthim

| Objektivi | | Aktivitetet | | Masat | Afati Kohor | Treguesi i matjes | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Fuqizimi i kapaciteteve komunale për riintegrim | | | | | | | | |
| | | 1.1 | Fuqizimi i zyrave, drejtorive komunale bazuar ne analizën e kapaciteteve | Rekrutimi i stafit shtese sipas nevojës.<br><br>Ricaktimi/plotësimi nga stafi i brendshëm | K2 -2022 | Zyrat te kompletohet me staf | Buxheti Komunal | K.Kaçanik | Strategjia kombëtare për riintegrim<br><br>Plani i veprimit |
| | | 1.2 | Vlerësimi i nevojave për trajnimin e stafit komunal | Shpërndarja e formularve te vlerësimit te nevojave te stafit<br><br>Plotësimi i formularit nga stafi | K2 -2022 | Nevojat për trajnim te vlerësuara | K.A | MAPL<br><br>DRPR<br><br>Donatoret | Strategjia kombëtare për riintegrim<br><br>Plani i veprimit |
| | | 1.3 | | Vlerësimi i rregullt i rezultatit te punës. | Ne Vazhdimësi | Nr.i vlerësimeve brenda vitit | K.A | MAPL<br><br>DRPR | Strategjia<br><br>Ligji për shërbimin civil |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Vlerësimi i performances se stafit | Vlerësimi i performances për shërbimet e riintegrimit | | | | K Kaçanik | |

| Objektivi | | Aktivitetet | | Masat | Afati Kohor | Treguesi i matjes | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | Fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimit në nivel | 2.1 | Vendosja e pikave te kontaktit për riintegrim | Caktimi i një personi kontaktues për riintegrim i caktuar nga secila drejtori/zyre | K1 -2022 | Zyrtarët e caktuar për riintegrim | K.A | ZKKK<br>DKA<br>QPS | Strategjia kombëtare për riintegrim<br>Plani i veprimit |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | horizontal dhe vertikal | | | | | | | ZP<br>DSHMS | |
| | | | | | | | | | |
| | | 2.2 | Bashkëpunimi i ZKK-e me zyrën e gjendjes civile (QKRC) për regjistrimin civil për pajisje me dokumente personale te personave te riatdhesuar | Referimi i rasteve në zyrat e gjendjes civile për regjistrim civil<br>Referimi i rasteve për pajisje me dokumente civile | Ne Vazhdimë si | Nr i rasteve të referuara për regjistrim civil<br>Nr i rasteve të referuara për pajisje me dokumente civile | K.A. | ZKKK<br>ZGJC<br>QKRS | Rregullorja QRK Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim<br>Plani i veprimit<br>Udhëzues |
| | | 2.3 | Bashkëpunimi i ZKK-e me drejtorin e arsimit për regjistrimin ne shkolla, për nostrifikimin e dokumenteve, organizimin e kurseve te gjuhës për fëmijët e riatdhesuar | Dërgimi i listave te fëmijëve për regjistrimin ne shkolla nga ZKKK ne DKA.<br>Identifikimi i fëmijëve me nevoja për kurse te gjuhës<br>Organizimi i kurseve te gjuhës<br>Nostrifikimi i dokumenteve | Ne Vazhdimë si | Nr i fëmijëve te regjistruar ne shkolla<br>Nr i fëmijëve qe kane përfituar kurse te gjuhës dhe mësim plotësues<br>Ne i dokumenteve te nostrifikuara | K.A. | DKA<br>MASHTI<br>ZKKK<br>DRPR<br>Donatore t | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2.4 | Bashkëpunimi i ZKK-e me zyret komunale te punësimit, QAP-at dhe themelim të bizneseve te personave te riatdhesuar | Referimi i personave te riatdhesuara për regjistrim ne zyrat komunale te punësimit si punëkërkues. | Ne Vazhdimë si | Nr i personave te regjistruar si punëkërkues. | K.A. | ZKKK<br>ZP<br>QAP<br>Drejtoritë Komunal e | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | 2.5 | Bashkëpunimi i zyrave dhe drejtorive komunale me Organizatat Ndërkombëtare dhe OJQ-te qe trajtojnë çështjet e riintegrimit | Takimet e rregullta<br>Organizimi i konferencave<br>Organizimi i forumeve te përbashkëta<br>Implementimi i projekteve te përbashkëta | Ne Vazhdimë si | Nr. i takimeve te rregullta<br>Nr. i konferencave te organizuara<br>Nr. i forumeve te përbashkëta<br>Nr. i projekteve te përbashkëta te implementuara | K.A. | ZKKK<br>DKA<br>QPS<br>ZP<br>ON<br>OJQ | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | 2.6 | Bashkëpunimi i ZKKK-ve me DRPR-ne për çështje te riintegrimit | Kontaktet e rregullta me koordinatore (ZLKR).<br>Pjesëmarrja ne takimet e organizuara nga DRPR<br>Raportimi i rregullt | Ne Vazhdimë si | Nr. i takimeve te rregullta<br>Nr. i raporteve të dërguara | K.A. | DRPR | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | |
| | | 2.7 | Bashkëpunimi i ZKKK-ve dhe drejtoritë me nivelin qendror për çështje te riintegrimit | Kontaktet e rregullta ne DRPR dhe ministritë përkatës.<br>Pjesëmarrja ne takimet e rregullta. | Ne Vazhdimësi | Nr. i raportimeve te shkëmbyera<br>Nr. i takimeve te përbashkëta. | | MPB/DRPR<br>MFPT<br>MASHTI<br>MSH<br>MMPHI<br>MAPL | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim<br>Plani i veprimit<br>udhëzuesi |

| Objektivi | Aktivitetet | | Masat | Afati Kohor | Treguesi i matjes | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 3 | 3.1 | Vlerësimi i nevojave te personave | Vizita e familjeve të riatdhesuara brenda 5 ditëve. | Në Vazhdimësi | Nr. i familjeve te vizituara | K.A. | ZKKK<br>DSHMS | Rregullorja Nr.22/2020 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Sigurimi i shërbimeve të garantuara me politikat e riintegrimit | | (familjeve) te riatdhesuar | | | | | DRPR QPS | Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Plotësimi i formularve brenda 5 ditëve | Në Vazhdimë si | Nr. i formularëve te plotësuara | K.A. | ZKKK<br>DSHMS<br>DRPR QPS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Identifikimi i nevojave në bazë të vlerësimit dhe përgatitja e planeve individuale të riinttegrimit. | Në Vazhdimë si | Nevojat e vlerësuara.<br>Nr. i planeve individuale të riinttegrimit. | K.A. | ZKKK<br>DSHMS<br>DRPR<br>QPS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | 3.2 | Ofrimi i shërbimeve shëndetësore dhe medikamente | Sigurimi i trajtimit mjekësor dhe medikamenteve për rastet në nevojë | Në Vazhdimë si | Numri i përfituesve | Programi i Riintegrimit | MFPT<br>MSH<br>DSHMS | Rregullorja Nr.22/2020 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | QPS | |
| | 3. | Ofrimi i shërbimeve psiko-sociale | Caktimi i specialistit për shërbime psiko-sociale nga Qendra për Mirëqenie Sociale për ofrimin e shërbimeve për rastet në nevojë. | Në Vazhdimësi | Specialistet për shërbime psiko-sociale te caktuara ne Komuna.<br>Numri i shërbimeve te ofruara | Programi i riintegrimit | MSH<br>DRPR<br>QPS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia |
| | | | Ofrimi i shërbimeve psiko sociale dhe familjare | Në Vazhdimësi | Numri i shërbimeve të ofruara | Programi i riintegrimit | MPMS DSHMS<br>QPS | Rregullorja Nr.22/2020 |
| | | | Ofrimi i ndihmës së rastit për grupet e cenueshme | Në Vazhdimësi | Numri i shërbimeve te ofruara | Programi i riintegrimit | Te gjitha Drejtoritë<br>MPMS<br>DRPR<br>MSH | Rregullorja Nr.22/2020 |
| | | | Asistenca sociale e familjeve ne nevojë | Ne Vazhdimësi | Numri i shërbimeve te ofruara | Programi i riintegrimit | MPMS<br>DRPR<br>DAS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>UIdhëzuesi |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | |
| | 3.4 | Qasja ne arsimim formal dhe joformal | Identifikimi dhe vlerësimi i nevojave te arsimimit. | Ne Vazhdimësi | Nevojat e vlerësuara | K.A | DKA<br>MASHT<br>ZKKK | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Ofrimi i mësimit plotësues për nxënësit ne nevojë | Ne Vazhdimësi | Nr i nxënësve te përfshire ne mësim plotësues | Programi i riintegrimit | MASHT<br>DKA<br>DRPR | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Nostrifikimi i dëftesave dhe diplomave | Ne Vazhdimësi | Numri i diplomave dhe dëftesave te nostrifikuara nga MASHT | K.A | MASHT | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Programet joformale te arsimimit | Ne Vazhdimësi | Numri i pjesëmarrësve ne Program | Programi i riintegrimit | DKA<br>MASHT | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit |
| | 3.5 | Riintegrimi ekonomik i të riatdhesuarve | Regjistrimi i te riatdhesuarve si punëkërkues | Ne Vazhdimësi | Nr i te regjistruarve si punëkërkues | K.A | DRPR<br>MPMS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Profilizimi i kandidateve | | Identifikimi i kapaciteteve | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Ofrimi i shërbimeve te punësimit | Ne Vazhdimësi | Nr i shërbimeve te ofruara | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | Rregullorja<br>Strategjia<br>Plani i veprimit |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Udhëzuesi |
| | | | Ofrimi i aftësimeve profesional | Ne Vazhdimësi | Nr. i përfituesve te aftësimit profesional | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | Rregullorja<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Financimi i planeve te biznesit | Ne Vazhdimësi | Nr. i përfituesve te Planit te biznesit | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Ofrimi i trajnimeve për ndërmarrësi | Ne Vazhdimësi | Nr. .i trajnimeve te ofruara<br>Nr. i përfituesve | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Sigurimi i konsulencës për përfituesit e bizneseve | Ne Vazhdimësi | Nr. i shërbimeve te ofruara | Programi i riintegrimit | DRPR<br>MPMS | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Udhëzuesi |
| | 3.6 | Banimi i qëndrueshëm | Sigurimi i banimit me qira | Ne Vazhdimësi | Numri i përfituesve | Programi i riintegrimit | MMPH | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Sigurimi i pakos dimërore | Ne Vazhdimësi | Numri i përfituesve | Programi i riintegrimit | DRPR | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Sigurimi i banimit përmes rindërtimit apo renovimit | Ne Vazhdimësi | Ne Vazhdimësi | Programi i riintegrimit | MMPH | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Sigurimi i mobilieve | Ne Vazhdimësi | Ne Vazhdimësi | Programi i riintegrimit | MMPH | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | Ndërtimi i banesave kolektive me bashkëfinancim | Ne Vazhdimësi | Numri i përfituesve | Programi i riintegrimit | MMPH<br>Donatoret | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |

| Objektivi | | Aktivitetet | | Masat | Afati Kohor | Treguesi i matjes | Kosto finaciare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | Vetëdijesimi publik dhe mobilizimi social | 4.1 | Informimi i personave te riatdhesuar për përfitimet dhe te drejtat e tyre | Shpërndarja e fletëpalosjeve informative | Ne vazhdimësi | Fletëpalosjet e shpërndara ne te gjitha pikat e kontaktit me te riatdhesuarit | Programi i riintegrimit | ZKKK | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim 2018-2020 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | | Organizimi i fushatave informuese për mundësinë e përfitimit | Ne vazhdimësi | Numri i fushatave informative | Progra mi i riintegr imit | | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim 2018-2020<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | | | | | | | | |
| | | 4.2 | Bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile për ofrimin dhe për zhvillimin e programeve të riintegrimit | Takimet me ON për zhvillimin e programeve te riintegrimit | Ne vazhdimësi | Nr i takimeve me ON | K.A. | Komuna Kaçanik | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia kombëtare për riintegrim 2018-2020<br>Plani i veprimit<br>Udhezuesi |
| | | | | Ofrimi i shërbimeve te riintegrimit ne bashkëpunim me shoqërinë civile | Ne vazhdimësi | Shërbimet e ofruara ne bashkëpunim | K.A. | ZKKK | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | me shoqërinë civile | | | Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |

| Objektivi | | Aktivitetet | | Masat | Afati Kohor | Treguesi i matjes | Kosto financiare | Institucionet e përfshira | Dokumentet Referuese |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Funksionalizimi i sistemit të monitorimit dhe vlerësimit (SMR) | | | | | | | | |
| | | 5.1 | Regjistrimi i vazhdueshëm i rasteve dhe arkivimi i dokumenteve ne SMR | Regjistrimi i rasteve ne SMR<br>Skanimi dhe vendosja e dosjeve, dokumenteve dhe vendimeve në SMR.<br>Regjistrimi i rasteve te reja | Ne Vazhdimësi | Te gjitha rastet e regjistruara dhe kompletuara ne SMR | K.A. | ZKKK | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | 5.2 | Monitorimi i rasteve përmes SMR-së | Monitorimi i mbështetjes dhe ndihmës te riatdhesuarve<br>Analiza e nevojave te identifikuara | Ne Vazhdimësi | Rastet e monitoruara ne vazhdimësi | K.A. | ZKKK | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | Vlerësimi i nevojave te plotësuara | | | | | Udhëzuesi |
| | | 5.3 | Gjenerimi i raporteve te rregullta nga SMR-ja | Printimi i raporteve te rregullta nga SMR | Ne Vazhdim ësi | Raportimi periodik | K.A. | ZKKK | Rregullorja Nr.22/2020<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |
| | | 5.4 | Përdorimi i te dhënave nga SMR ne zhvillimin e politikave e te riintegrimit ne nivel lokal. | Analiza e situatës<br>Përgatitja e rekomandimeve bazuar ne rezultatet e analizës<br>Zhvillimi i vazhdueshëm i politikave. | Ne Vazhdim ësi | Avancimi i politikave ne vazhdimësi | K.A. | Komuna Kaçanik | Rregullorja<br>Strategjia<br>Plani i veprimit<br>Udhëzuesi |

## Zyra ligjore

Plan –Programi i Punës së përfaqësuesit ligjor është tejet i varur nga faktorë të ndryshëm si : Afatet ligjore , ecuria e lëndëve , radha e caktuar nga Gjykatat Themelore , Apelit dhe Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës .

**1. Përfaqësimi në Gjykatë**

-Përfaqësimin e bënë përfaqësuesi i komunës

-Afati: sipas dinamikës të cilën e caktojnë gjykatat.

**2. Ushtrimi i padive**

-Ushtrimin e padive e bënë përfaqësimi i komunës

-Afati : Menjëherë pas arritjes së kërkesave nga ShCK.

**3. Ushtrimi i mjeteve juridike**

-Mjetet juridike i ushtron përfaqësuesi i komunës brenda autorizimeve dhe urdhëresave të veta me autorizim nga kryetari.

-Afati : Brenda afateve ligjore të parapara

**4. Këshilla juridike**

-Përfaqësuesi i komunës jep edhe këshilla juridike sipas nevojës brenda SHCK-së.

-Afati: Në vazhdimësi dhe sipas nevojës .

**5. Përpunimi i Akteve Ligjore**

- Në bashkëpunim me drejtori përkatëse bëjnë përpunimin e Akteve Ligjore.

-Afati : Sipas nevojës

**6. Përcjellja e ligjeve**

-Zyra ligjore e komunës përcjell gjitha ligjet të cilat i miraton Kuvendi i Republikës së Kosovës

-Afati : Në vazhdimësi

**7. Koordinimi i Punëve Juridike**

-Përfaqësuesi ligjor i komunës do të bëjë koordinimin e gjitha punëve juridike të SHCK-së dhe Gjykatave.

-Afati: Në vazhdimësi

## Plani i Punës për Sektorin e Inspektoratit

Me qëllim të monitorimit dhe zbatimit të ligjeve dhe dispozitave të tjera në fushat përkatëse, inspektorati me anë të këtij plani ndërmerr masa parandaluese për zbatimin e normave dhe rregullave të caktuara. Inspektorati është përgjegjës dhe mbikqyrë aktivitetet të lidhura

me zhvillimin ekonomik, tregun, mbrojtjen e mjedisit, shëndetin e popullatës, transportin publik të udhëtarëve dhe mallërave, mbrojtjen e pyjeve etj. Inspektorati është autoritet rregullator në komunë.

Ligjet relevante të cilat do t`i aplikon inspektorati janë:

Ligji për Vetëqeverisje Lokale 2008/03-L040, Ligji nr. 02/L-123 Për Organizimin e Bizneseve, Ligji nr. 2004/17 Për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ligji nr. 2004/18 Për Tregtinë e Brendshme, Ligji nr. 04/L-005 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2004/18 Për Tregtinë e Brendshme, Ligji nr. 02/L-1 Për Inspektimin e Tregut, Ligji nr. 02/L-36 Ligji për Duhanin, Ligji nr.03/L-131 Për ndryshimin dhe shtesën në ligjin nr. 2004/17 Për Mbrojtjen e Konsumatorit, Ligji nr. 2003/22 Për Inspektoratet Sanitare në Kosovë, Ligji nr. 2003/25 Për Kadastër, Ligji nr. 04/L-110 Për Ndërtim, Ligji nr. 02/L-96 Për Ndryshimet dhe shtesat në Ligjin nr. 2003/25 Për Kadastrën, Ligji nr. 03/L-091 Për Përdorimin, Menaxhimin dhe Mirëmbajtjen e Ndërtesave me Pronësi të Përbashkët, Ligji nr. 2003/11 Për Rrugët, Ligji nr. 02/L-70 Për Sigurinë në Komunikacion Rrugor, Ligji nr. 03/L-120 Për Ndryshimin dhe shtesën në Ligjin nr. 2003/11 Për Rrugët, Ligji nr. 2004/20 Për Ruajtjen e Natyrës, Ligji nr. 2004/24 Për Ujin, Ligji nr. 2006/31 Për Mbeturinat, Ligji nr. 14/2003 Për Planifikimin Hapësinor, Ligji nr. 02/L-102 Për Mbrojtjen nga Zhurma, Rregullorja për Transport Rrugor në Teritorin e Komunës së Kaçanikut 01-nr. 02-04-80/07, Rregullorja për Shërbime Publike 01Nr.16-12260/14, Rregullorja për Menaxhimin e Mbeturinave në komunën e Kaçanikut 01Nr.07-60/01-17890/19;

| Aktivitetet e planifikuara | Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve | | Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara | Partnerët implementues të aktiviteteve | Buxheti | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | Koha | Vendi | | | Komuna | Donacione |
| **1. Inspektimi në Komunikacionin Rrugor nëpër rrugët lokale të komunës së Kaçanikut** | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.1 Inspektimi në komunikacion, përfshirë transportin publik me autobusë në linjat urbane- periferike, kombi bus dhe autotaksi;<br><br>1.2 Inspektimi i automjeteve me mbingarkesë të barrës,<br><br>Inspektim në trafikun urban dhe urbano-periferik, | janar – dhjetor 2022 | Komuna | 1. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve sa më efikase në transportin publik të udhëtarëve, në vijat e rregullta dhe ato jashtë linjës sipas ligjeve në fuqi dhe rregullores komunale:<br><br>Ndalimi i mbingarkesës për autobusë dhe kombi bus, respektimi i orarit, dhe rendit të udhëtimit, performancë më e mirë e transportit publik.<br><br>Në rast se operatorët veprojnë në kundërshtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi, atëherë do të merren masa konform ligjeve. | Sektori i inspektoratit – Inspektori i komunikacionit,<br><br>Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;<br><br>Policia e Kosovës dhe sipas nevojës inspektorët qeveritar të komunikacionit. | | |
| **2. Inspektimi i Ndërtimeve pa leje në teritorin e komunës së Kaçanikut** | | | | | | |
| 2.1 Kontrollimi i ndërtimeve në tërë territorin e komunës sonë,<br><br>2. Mbajtja e procesverbaleve mbi gjendjen e punimeve<br><br>nëpër objektet e inspektuara;<br><br>3. Dhënia e urdhëresave mbi ndalimin e ndërtimeve dhe<br><br>Aktvendimeve për ndalimin e ndërtimeve, të cilat zhvillohen | janar – dhjetor 2022 | Komuna | 1. Parandalimi i ndërtimeve pa leje si dhe vetëdijësimi i qytetarëve që të pajisen me dokumentacione për leje ndërtimi nga drejtoria përkatëse.<br><br>2. Parandalimi i ndërtimeve të egra duke marr masa konform ligjeve në fuqi. | Sektori i inspektoratit – Inspektori i ndërtimtarisë,<br>Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;<br><br>Policia e Kosovës. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| në kundërshtim me lejen e lëshuar nga drejtoria;<br><br>4. Dhënia e Aktvendimeve mbi rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje, ose të objekteve të cilët janë duke u ndërtuar pa leje; | | | | | | |
| **3. Inspektimi në Mbrojtjen e Mjedisit në teritorin e Komunës së Kaçanikut** | | | | | | |
| 1. Inspekton ndotjen e ajrit, dheut dhe ujit të<br><br>shkaktuara nga veprimtaritë industriale,<br><br>2. Inspekton kontaminimin, mbeturinat, materiet e<br><br>rrezikshme dhe zonat e mbrojtura në natyrë.<br><br>3. Mbikëqyrjen e menaxhimit dhe eksploatimit të<br><br>resurseve natyrore.<br><br>4. Mbikëqyrja e punëve të gurëthyesve. | janar – dhjetor 2022 | Komuna | 1.Parandalimi i ndotjes së Mjedisit, përfshirë ndotja e ujit, e ajrit, tokës, të cilët do të ndikonin pozitivisht në shëndetin publik të qytetarëve të komunës sonë.<br><br>2. Parandalimi i shfrytëzimit të pakontrolluar të resurseve natyrore gjatë eksploatimit të gurit.<br><br>3. Parandalimi i shkatërrimit ose degradimit të pyjeve, parqeve nacionale dhe monumenteve të mbrojtura të natyrës. | Sektori i inspektoratit-<br><br>Inspektori mjedisor;<br><br>Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;<br><br>Policia e Kosovës;<br><br>Inspektorati mjedisor nga niveli qendror; | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 5. Inspektimi i një varg veprimtarive<br><br>pa njoftim të pronarit.<br><br>6. Mbikëqyrja dhe mbrojtja e ambientit në aspektin e mbeturinave, kanalizimit, ujit.<br><br>7. Bën planifikimin lokal të ambientit, masat tjera<br><br>mbrojtëse ndaj zhurmës, trafikut.<br><br>8. Bën procesverbale dhe fletëparaqitje për shkelësit e propozon masa për dispozitave ligjore dhe eliminimin e faktorëve që ndikojnë në ndotjen e ambientit. | | | | | | |
| **4. Inspektimi në lëminë e Shërbimeve Publike** | | | | | | |
| 1. Bashkëpunon dhe inspekton me policinë e Kosovës rreth lirimit të trotuareve nga parkingjet ilegale; | janar – dhjetor 2022 | Komuna | 1. Rritja e sigurisë në komunikacion dhe të bëhet lëvizja e papenguar e këmbësorëve;<br>2. Parandalimi i vendosjes së reklamave të pa leje paraprake komunale;<br>3. Të ruhet prona publike dhe intervenimet në pronë publike të bëhen vetëm me leje komunale; | Sektori i inspektoratit – Inspektori i shërbimeve publike, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2. Inspekton vendosjen e reklamave nëpër hapësira publike;<br><br>3. Inspekton dhe intervenon në raste kur dëmtohet prona komunale, si psh prerja e asfaltit, dëmtimi i trotuareve, dëmtimi i shenjave të komunikacionit, dëmtimi i shenjave të emërtimit të rrugëve publike, dëmtimi i shtyllavë të ndriçimit publik,<br><br>dëmtimi i rrjetit të kanalizimit, dëmtimi i rrjetit të ujësjellësit pa leje komunale etj.<br><br>4. Bën inspektimin e deponive ilegale të mbeturinave; | | | 4. Të kemi një ambient të pastërt; | Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;<br><br>Policia e Kosovës dhe në bashkëpunim të ngushtë më të gjitha institucionet përkatëse. | | |
| **5. Inspektimi në lëminë e Pylltarisë në territorin e komunës së Kaçanikut** | | | | | | |
| 1.Mbikqyrja e të gjitha aktivitet që kryhen në pyje.<br><br>2.Mbikqyrja e realizimit të planeve menagjuese. | janar-dhjetor 2022 | Komuna | 1. Mbrojtja e pyjeve nga prerjet ilegale të drunjëve që janë nën kompetenca komunale dhe marrja e masave konform ligjeve në fuqi. | Sektori i inspektoratit – Inspektori i pylltarisë, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3. Kontrollimi i librave afariste dhe dokumentacionit tjetër me qëllim verifikimit të zbatimit të ligjit dhe dispozitave të tjera mbi pyjet.<br><br>4. Kontrollimi i dokumentacionit të dëmkosjes dhe origjinës së prodhimeve pyjore.<br><br>5. Ndalimi i prerjeve të drunjëve të cilat nuk kryhen në pajtim me ligjet për pyjet.<br><br>6. Urdhëron që të kryhen punët sipas planeve menaxhuese.<br><br>7.Konfiskimin e drunjëve të prerë në mënyrë të kundërligjshme. | | | | Puna ekipore e përbashkët e inspektorëve;<br><br>Policia e Kosovës dhe në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha institucionet përkatëse. | | |
| **6. Inspektimi në lëmin e tregut në teritorin e komunës së Kaçanikut** | | | | | | |
| Kontrollimi dhe mbikëqyrja e tregut dhe të subjekteve të biznesit, nga kompetencat e | | | 1. Funksionim sa më i mirë i të gjitha lokaleve afarite të subjekteve biznesore. | Sektori i inspektoratit – Inspektori i tregut, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 8.2 Mirëmbajtja e kanalizimeve fekale të pa menaxhueshme. | mars – nëntor<br>2022 | Komuna Kaçanik | Mirëmbajtje e invstimeve, parandalimi i epidemive të ndryshme dhe ruajtja e ambientit. | DSHPE-ja, Kompania kontraktues për realizimin e këtij projekti. | Komuna<br>Kontratë njëvjeçare | |
| **9. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit atmosferik në qytet.** | | | | | | |
| 9.1 Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit atmosferik në qytet dhe lokalitete rurale | mars- tetor<br>2022 | Komuna Kaçanik | Mirëmbajtje e invstimeve, parandalimi i vërshimeve të mundshme, nga reshjet e mëdha të shiut. | DSHPE-ja,<br>Kompania kontraktues për mirëmbajtje te rrjeteve të kanalizimit. | Komuna<br>Kontratë njëvjeçare | |
| **10. Menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, gjelbëruese dhe parqeve publike.** | | | | | | |
| 10.1 Pastrimi i rrugëve kryesore të qytetit dhe | janar – dhjetor | Komuna Kaçanik | Krijimi i një ambienti më të pastër dhe më të bukur për qytetarë, mirëqenie më të | DSHPE-ja,<br>Kompania e kontraktuar, | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| hapësirave të ndryshme publike . | 2022 | Zona Urbane | mirë. Ruajtja e shëndetit të qytetarëve. | Vullnetarë | | |
| 10.2 Pastrimi i varrezave të dëshmorëve dhe pllakave përkujtimore. | janar – nëntor<br>2022 | Komuna<br>Kaçanik | Ambienti me të pastër dhe më të bukur përvizitorët.<br>Ruajtja me e mirë e këtyre monumenteve. | DSHPE-ja,<br>Kompania e kontraktuar,<br>Vullnetarë | | |
| 10.3 Lëshimi i lejeve të reja për shfrytëzim të përkohshëm të hapësirave publike. | janar – nëntor<br>2022 | Komuna Kaçanik | Mundësi për zhvillim të bizneseve individuale, promovim të produkteve. | DSHPE-ja | | |
| 10.4 Lëshimi i lejeve të reja për shfrytëzim të përkohshëm të vendparkingjeve publike. | janar – nëntor<br>2022 | Komuna Kaçanik | Krijimi i mundësive për hapësira të sigurta për parkim të banorëve të banesave kolektive dhe bizneseve. | DSHPE-ja | | |
| 10.5 Menaxhimi i vendparkingjeve në rrugët kryesore të zonës urbane të qytetit | janar – ëntor<br>2022 | Komuna Kaçanik | Shtimi i të hyrave vetanake përmes Rregullores për Taksa Komunale | DSHPE-ja<br>Kompania e kontraktuar | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 11.**Menaxhimi i mbeturinave** | | | | | | |
| 11.1 Largimi i deponive ilegale të mbeturinave | mars- prill<br><br>2022 | Zona të caktuara në territorin e komunës | Ambienti më i pastër | DSHPE-ja<br><br>DUKMM-ja<br><br>KRM"Pastërtia"-njësia operative Kaçanik | Komuna<br><br>**20,000.00€** | |
| 11.2 Hartimi i Planit të ri Lokal për Menaxhim të Mbeturinave Komunale 2022-2026 | shkurt-dhjetor<br><br>2022 | Komuna<br><br>Kaçanik | Zgjërimi i ofrimit të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave në zonat ku nuk ofrohet shërbimi.<br><br>Kompostimi dhe Riciklimi | DSHPE-ja<br><br>KRM "Pastërtia"-njësia operative Kaçanik, NPSH" Krasniqi", MEA,GIZ-i | | MAP,MEA, GIZ-i |
| **12. Gatishmëria për mbrojtje dhe shpëtim ( Emergjenca)** | | | | | | |
| 12.1 Përgjigje 24 orë e Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit në: zjarre, aksidente teknologjike, të komunikacionit dhe fatkeqësitë natyrore. | janar-dhjetor<br><br>2022 | Komuna<br><br>Sektori i Emergjencave | Mbrojtja e qytetareve dhe e pasurisë nga rreziqet e mundshme, krijimi i një ambienti të sigurt për qytetaret. | Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, njësit vullnetare. | | Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 12.2 Përcjellja e trajnimeve të ekipeve të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit, sipas udhëzimeve nga Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. | mars-tetor<br>2022 | Komuna<br>Sektori i Emergjencave | Përfitimi i njohurive të reja në mbrojtjen e popullatës dhe pasurisë së tyre, intervenime me efikase në raste të emergjencave. | DSHPE-ja, Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit.<br>Ekipet vullnetare. | | |
| 12.3 Shtimi i masave mbrojtëse ndaj zjarrit për fushatën e korrje-shirjeve, në marrjen e masave parandaluese ndaj këtyre dukurive. | qershor-gusht<br>2022 | Komuna<br>Kaçanik | Parandalimi i zjarreve gjate korrje-shirjeve në muajin Korrik, krijimi i kushteve të sigurta gjatë kësaj fushate, krijimin e kushteve të volitshme të punës për kombajnerët. | DSHPE-ja, Zyrtari i Parandalimit, Drejtoria e Bujqësisë, dhe Kombajnerët. | | |
| 12.4 Organizimi i mbajtjes së ushtrimit, mbrojtja nga zjarri për nxënësit e parashkollorë dhe klasat e para fillore me temën: fikja e zjarreve fillestare<br>me aparate për fikjen e zjarrit. | qershor 2022 | Me shkollat fillore<br>në teren | Sensibilizimi i dhe përfitimi i njohurive të nxënësve për fikjen e zjarreve fillestare me aparate për fikjen e zjarrit | Sektori i Emergjencave<br>NJPZSh - Kaçanik | | |
| 12.5.Evidentimi dhe propozimi i punëve dhe aktiviteteve, për eliminimin e pikave Emergjente të cilat | Gjatë vitit<br>2022 | Komuna<br>Kaçanik | Zvogëlimi i rrezikut dhe dëmeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës,<br>Sektori i emergjencave | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| paraqesin rrezik në territorin e komunës.<br>(Pastrimi i përroskave dhe lumenjve nga materialet inerte) | | | | | | |
| 12.6 Koordinimi i punëve dhe aktiviteteve të rregullta në mes të Emergjencës, PK, Kryqi i kuq-Kaçanik KFOR-it, OJQ- të | Gjatë vitit<br>2022 | Kaçanik | Marrja e masave dhe reagim i shpejtë mes agjencioneve të përfshira në situata emergjente. | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës,<br>Sektori i emergjencave | | |
| 12.7 Planifikimi dhe pajisja me mjete materialo -teknike për QOE lokale | Gjatë vitit<br>2022 | QOEL<br>Qendra Operative Emergjente Lokale | Organizimi dhe koordinimi i mirëfilltë me akterët relevant në rast emergjence. | Drejtoria e Shërbimeve Publik dhe Emergjencës,<br>ZAKE – Zyra e Alarmiit dhe Koordinimit Emergjent | | |
| 12.8 Rifreskimi i Planit: Vlerësimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. | mars-qershor<br>2022 | Komuna<br>DSHPE-ja | Plotësimi i ndryshimeve të ndodhura në infrastrukturën e komunës me Planin: Vlerësimi i rrezikut nga | Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës,<br>Sektori i emergjencave | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. | | | |

**Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë**

## Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport

| Aktivitetet e planifikuara | Implementimi i aktiviteteve | | Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara | Partnerët implementues të aktiviteteve |
|---|---|---|---|---|
| | Koha | Vendi | | |
| **1.** Shënimi i të gjitha datave të Rënies së Dëshmorëve në Komunën tonë | Janar-dhjetor 2022 | Nëpër vendbanimet komunale | Përkujdesja dhe përkujtimi i Luftës së Lavdishme të UÇK dhe Dëshmorëve | Komuna, DKRS, Shoqatat e Dalura nga Lufta, Qendra Kulturore „Kaçaniku", SHKA-të etj. |
| **2.** Shënimi i Përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës | 17 shkurt 2022 | Shtëpia e Kulturës dhe<br>Palestra e Sportit | Shënimi i kësaj date historike të Shtetit të Kosovës | Komuna, DKRS,DA, Shoqatat e Dalura nga Lufta,OJQ të ndryshme, Klubet Sortive etj |
| **3.** Epopeja e UÇK-së | 5,6,7 mars 2022 | Varrezat e Dëshmorëve | Përkujdesja dhe përkujtimi i luftës së lavdishme të UÇK | Komuna, DKRS,<br>Shoqatat e Dalura nga Lufta etj. |
| **4.** Turneu Memorial i Shahut "Reshat Shehu" | 9 prill 2022 | Shtëpia e Kulturës | Përkujdesja dhe përkujtimi i Dëshmorit "Reshat Shehu" | Komuna, DKRS, Klubi i Shahut, Federata e Shahut e Kosovës, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe donatorë tjerë.. |
| **5.** Dita Ndërkombëtare e Sportit për Paqe | 6 prill 2022 | Palestra e Sportit | Angazhimi i të rinjve në sport Rëndësia e sportit, | Komuna, DKRS, DA, KOKU,OJQ-të, KVRL , Klube Sportive, Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike tj.. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Shkollat, fushat sportive etj | shënimi i kësaj date, ndërkombëtare me mesazh paqeje etj. | |
| **6.** Dita Ndërkombëtare e Tokës | 22 prill 2022 | Shtëpia e Kulturës,<br>Parku i Qytetit etj,, | Sensibilizimi i shoqërisë për ruajtjen e ambientit | Komuna, DKRS, KOKU,OJQ-të, KVRL , Klubet Sportive, Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike tj.. |
| **7.** Dita Ndërkombëtare e Librit | 23 prill 2022 | Shtëpia e Kulturës | Sensibilizimi i shoqërisë për rëndësinë e librit, leximit, krijimit dhe përurimit të tij | Komuna, DKRS, DA, OJQ-të, KVRL , etj.. |
| 8. Dita ndërkombëtare kundër duhanit me moton Sport- jo duhan | 31 maj 2022 | Palestra e Sportit | Angazhimi i të rinjve në sport dhe largimi nga dukuritë negative | Komuna, DKRS,DA, OJQ-të, KVRL , Klube Sportive, Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike tj.. |
| **9.** Festivali i këngës popullore për fëmijë | Maj 2022 | Shtëpia e Kulturës | Ruajtja e vlerave tradicionale kulturore, zbulimi i talentëve-ve në këndim . | Komuna, DKRS,DA, Qendra Kulturore, SHKA-të etj.. |
| **10.** Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve | 1 qershor 2022 | Shtëpia e Kulturës | Sensibilizimi i shoqërisë për të drejtat e fëmijëve | DKRS në bashkëpunim me DA, Shkollat, KVRL, Klubet Sportive etj |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **11.** Dita botërore e sportit dhe ambientit | 5 qershor | Shtëpia e Kulturës, Parku i Qytetit, Palestra e Sportit etj. | Angazhimi i të rinjve në sport dhe senzibilizimi i të rinjëve dhe shoqëris në ruajtjen e ambientit | Komuna, DKRS,DA, OJQ-të, KVRL , Klube Sportive, Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike tj.. |
| **12.** Festivali mbarë Kombëtar për ditën e Çlirimit të Kaçanikut dhe aktivitete tjera kulturo-sportive | 11 qershor 2022 | Shtëpia e Kulturës, Bulevardi Ismail Raka, Palestra Sportive | Shënimi i kësaj date historike, Ruajtja e vlerave tradicionale kulturore e sportive | Komuna, DKRS,DA, Shoqatat e Dalura nga Lufta, Qendra Kulturore, SHKA-të, Klubet Sportive, etj.. |
| **13.** Dita Olimpike -Vrapimi i 14. fëmijëve të lindur në vitin e shpalljes së Pavarësise së Kosovës | 23 qershor 2022 | Bulevardi “Ismail Raka” | Angazhimi i të rinjve në sport – Rëndësia e sportit, shënimi i kësaj date, etj. | Komuna, DKRS,DA, KOKU,OJQ-të, KVRL , Klubet Sportive, Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike tj.. |
| 14. Manifestimi me moton „Mirë se vini mërgimtarë”-aktivitete kulturore-sportive | 28 korrik 2022 | Shtëpia e Kulturës-Palestra Sportive | Tubimi i mërgimtarëve dhe respekti për kontributin e tyre | Komuna, DKRS dhe OJQ-t Lokale Rinore e Sportive . |
| **15.** Dita e Dëshmorëve | 10 gusht 2022 | Shtëpia e Kulturës | Përkujdesja dhe përkujtimi i Luftës së Lavdishme të UÇK-s dhe Dëshmorëve | Komuna, DKRS, Shoqatat e dalura nga lufta, klubet sportive etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **16.** Panairi i Sportit | 1 shtatorë 2022 | Palestra sportive | Senzibilizimi i të rinjëve, për marrjen me sport , dhe prezentimi i të arriturave të klubeve sportive | DKRS, OJQ-të, KVRL , Kluubet Sportive, Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike tj.. |
| 17. Java e Rinisë 2022 | 10-19 shtator 2022 | Shtëpia e Kulturës dhe Palestra e Sportit | Aktivizimi i të rinjve në aktivitete të ndryshme rinore e sportive | Komuna, DKRS, DA, OJQ-të, KVRL , Klubet Sportive, Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike, kryqi i Kuq, Qendrat Rinore etj.. |
| **18.** Java Europiane e Sportit në Kosovë | 23-30 shtator | Palestra e Sportit | Angazhimi i të rinjve në sport – Rëndësia e sportit,<br>shënimi i kësaj date, etj. | Komuna, DKRS,DA, KOKU,OJQ-të, KVRL ,Klubet Sportive, Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike tj.. |
| **19.** Dita botërore e të moshuarëve | 1 tetor | Bulevardi Ismail Raka, Parku i Qytetit, | Senzibilizimi i shoqërisë për respektin, ndihmën që duhet të kemi ndaj të moshuarve. | Komuna, DKRS, KOKU,OJQ-të, KVRL , SHBA, Kryqi i Kuq etj.. |
| **20.** Dita Botërore e Ecjes | 3 tetor 2022 | Bulevardi Ismail Raka, Parku i Qytetit, apo Livadhet e Shtrazës | Senzibilizimi i të rinjëve, moshuarve etj për marrjen me sport , përkatësisht rëndësinë e ecjes në natyrë. | Komuna, DKRS, KOKU,OJQ-të, KVRL , Klube Sportive, SHBA Kaçaniku,Shoqata e Pedagogeve te Kultures Fizike tj.. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **21.** Gitariada me Rock Grupet Kaçanikase | 20 tetor 2022 | Shtëpia e Kulturës | Avancimi dhe kultivimi i rock muzikës nga artistët tanë. | Komuna, DKRS, OJQ-të, Rock Grupet etj.. |
| **22.** Festat e Nëntorit | 28 nëntor 2022 | Shtëpia e Kulturës | Përkujtesa e kësaj ngjarje të madhe historike. | Komuna, DKRS,Qendra Kulturore Shoqatat e Dalura nga Lufta etj.. |
| **23.** Dita ndërkombëtare e personave me aftësi të kufizuara | 3 dhjetor 2022 | Shtëpia e Kulturës-Palestra e Sportit | Sensibilizimi i shoqërisë për personat me nevoja të veçanta | Komuna, DKRS,Handikos, OJQ-të etj.. |
| 24. Dita botërore e vullnetarëve | 5 dhjetor | Bulevardi Ismail Raka, Parku i Qytetit, | Senzibilizimi i shoqërisë për rëndësinë e punës vullnetare -<br>shënimi i kësaj date, etj. | Komuna, DKRS, KOKU,OJQ-të, KVRL , Klube Sportive, SHBA Kaçaniku,etj.. |
| **25.** Manifestimi përmbyllës-Mirënjohje për më të mirët në lëmin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit | 29 dhjetor 2022 | Shtëpia e Kulturës | Mirënjohje dhe rrespekt për angazhimin dhe të arriturat në kulturë, rini dhe sport. | Komuna, DKRS,SHKA-t, Klubet Sportive etj.. |
| **26.** Garat sportive- turnire nga të gjitha lëmitë sportive | janar - dhjetor 2022 | Palestra e Sportit | Angazhimi i të rinjve në sport Rëndësia e sportit dhe zbulimi i talentëve të rinjë , | Komuna, DKRS, DA, Klubet sportive, Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike etjj.. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| me nxënësit e SHFMU dhe SHFML | | | pjesëmarrja në gara komunale, regjionale, shtetërore etj. | |
| **27.** Aktivitete futbollistike me personat me aftësi të kufizuara – All Equall | janar - dhjetor 2022 | Palestra e Sportit | Angazhimi i personave me aftësi të kufizuara në sport – aktiviteti me moton të gjithë jemi të barabartë - All Equall | DKRS,Federata e Futbollit të Kosovës , Handikos. |
| **28.** Subvencionimi i klubeve Sportive, SHKA-ve dhe OJQ | janar - dhjetor 2022 | Komuna e Kaçanikut | Mbarëvajtja e garave dhe aktiviteteve për klube shoqëri dhe OJQ. | Komuna, DKRS, Klubet Sportive, Shoqëritë Kulturo-Artistike, OJQ-të |
| 29. Projekte, nisma apo aktivitete në procedurë shqyrtimi ose të miratuara nga organet kompetente | janar - dhjetor 2022 | Komuna e Kaçanikut | Bashkëpunim i vazhdueshëm me partnerë të mundshëm . | Komuna, DKRS, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit |
| **30.** Organizimi i aktiviteteve përuruese, ekspozitave dhe orëve letrare; si dhe hulumtimi-identifikimi në masë i relikteve historike etno-kulturore (dhe depozitimi- grumbullimi i mundshëm i tyre), me synim muzeun e qytetit | janar - dhjetor 2022 | Komuna e Kaçanikut | Bashkëpunim i vazhdueshëm me partnerë të mundshëm . | Komuna, DKRS etj. |
| **31.** Aktivitete përuruese dhe aktivitete të tjera eventuale, që mund të ofrohen, | | | | Komuna, DKRS etj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| organizohen dhe implementohen bashkë ose vetëm nga organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare. | janar - dhjetor 2022 | Komuna e Kaçanikut | Bashkëpunim i vazhdueshëm me partnerë të mundshëm institucionalë, organizata joqeveritare dhe vullnetarë të ndryshëm | |

## Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit

| **Aktivitetet e planifikuara** | **Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve** | | **Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara** | **Partnerët implementues të aktiviteteve** | **Buxheti** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Koha** | **Vendi** | | | **Komuna** | **Donacione** |

| 1.Sektori i Zhvillimit Ekonomik | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.1** Hartimi i dokumenteve të nevojshme strategjike dhe implementuese rreth zhvillimit ekonomik (hartimi i strategjisë së zhvillimit ekonomik lokal, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financave, Hartimi i KABK-Komunal ,hartimi i planeve implementuese për zhvillimin e sektorëve në interes të Komunës etj.<br>**1.2** Implementimi dhe zbatimi i projekteve te listuara ne Strategjinë Zhvillimore Lokale. | janr-qershor 2022 | Komuna Kaçanik | Përmirësimi dhe ngritja e kapaciteteve prodhuese lokale, zhvillim i qëndrueshëm ekonomik, ngritje e nivelit të punësimit, përmirësim i ambientit afarist. | Komuna përmes resurseve vetjake humane - me mundësi të gjetjes se donatorëve përmes përfitimit të ndonjë asistence teknike-profesionale. | Komuna Kaçanik | |
| **1.3** Insistimi tek ministritë gjegjëse për miratimin e zonave ekonomike ekzistuese (te shpallura me vendim te Kuvendit Komunal) dhe identifikimi dhe shpallja e zonave të reja. | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Krijimi i vendeve të reja të punës, ofrimi i kushteve optimale e të bërit biznes investitorëve potencial, nxitja e zhvillimit të sektorit privat, etj. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkëpunim me drejtorinë e Urbanizmit, Kadastrit dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. | Komuna Kaçanik | |
| **1.4** Aplikimi i politikave më të mira të Komunës, me qëllim të rritjes së numrit të bizneseve, përmes aplikimit të metodave më të mira në lehtësimit e të bërit biznes. | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Shtimi i numrit te bizneseve ne territorin e Komunës, përmirësimi i jetës se qytetareve. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit. | Komuna<br>Buxheti vjetor i planifikuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.5** Përzgjedhja e programeve zhvillimore dhe krijimi i partneriteteve me subjektet vendore dhe të jashtme të nevojshme, që të realizohen projektet e planifikuara si: Ministritë përkatëse, Bizneset, Fermerët, OJQ-të profesionale, fondet e ndryshme te BE-së, AZHR-Lindje,etj. | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Realizimi dhe përshpejtimi i projekteve komunale ekzistuese dhe te reja. | Komuna – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkëpunim me drejtoritë tjera | Komuna<br><br>Buxheti vjetor i planifikuar | |
| **1.6** Subvencionimi i bizneseve | prill-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Nxitja e aktiviteteve të reja dhe përkrahja e aktiviteteve ekzistuese biznesore. | Komuna – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit ,Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave, Zyra e Kryetarit dhe Donatorët si: Help Kosovo, USAID, Fondacioni Kosovë Luxemburg,etj. | Komuna<br><br>Buxheti vjetor i planifikuar | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.7 Hartimi i ofertave (Aktivitetet promovuese)**:<br><br>**1.7.1** Organizimi i aktiviteteve promovuese për përparësitë dhe mundësitë komunale si: ofertat për investime, oferta komunale për te bërit biznes, taksat komunale, politikat ekonomike lokale, etj. | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Thirrja-lobimi për investime te reja në Komunën e Kaçanikut, nxitja e krijimit të bizneseve lokale. | Komuna përmes mundësive vetjake financiare - me mundësi të gjetjes se donatorëve përmes përfitimit të ndonjë asistence financiare. | Komuna<br><br>Buxheti vjetor i planifikuar i kontratës | |
| **1.7.2** Përpilimi i broshurave promovuese (zonat ekonomike dhe potencialeve tjera komunale, bukuritë natyrore, historike/trashëgimore, zonat malore/ujore etj. | janar-qershorë 2022 | Komuna Kaçanik | Thirrja-lobimi për investime te reja në Komunën e Kaçanikut, nxitja e krijimit të bizneseve lokale. | Komuna përmes mundësive vetjake financiare - me mundësi të gjetjes se donatorëve përmes përfitimit të ndonjë asistence financiare | | |
| **1.7.3** Pjesëmarrja në Panairin e Komunave të Kosovës. | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Komuna e Kaçanikut synon që gradualisht të forcojë mundësit dhe kapacitetet e veta edhe në aspektin<br><br>e promovimit të mundësive për afarizëm. | DZHET – KOMUNA KAÇANIK | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.8**<br><br>Organizimi i takimeve të bizneseve të cilat operojnë ne territorin e Komunës me Ministritë e ndryshme dhe Organizatat tjera relevante si KIESA (Agjensioni për përkrahjen dhe zhvillimin e NVM-ve) , KEDS, Dogana e Kosovës etj. | mars-dhjetor<br><br>2022 | Komuna Kaçanik | Permes ketyre takimeve përfaqësuesit e bizneseve kanë mundësinë që të permiresojnë kontaktet, të lidhin kontakte te reja, të bëjnë kordinimin e punëve të tyre, ti paraqesin gjitha brengat dhe pengesat gjatë operimit te veprimtarisë së tyre para ketyre akterëve kyq, të cilët janë të obliguar që të rregullojnë legjislacionin dhe kushtet tjera për të bërit biznes në territorin e Republikës së Kosovës. | Komuna – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| **1.9** Bashkëpunimi me Odën Ekonomike Kosovare | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Ndërmjetësimi i bizneseve lokale me OEK-në Orientimi i strategjisë zhvillimore, asistimi për bashkëpunim serioz dhe te vazhdueshëm me këtë institucion. | Komuna Kaçanik- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit -OEK | | |
| **1.10** Realizimi i gjitha projekteve të planifikuara sipas ndarjeve buxhetore të vitit 2022 si:<br><br>A) Ndertimi i infrastruktures ne zonat industriale, shuma 5,000.00 € (kodim | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Permiresimi i vazhdueshëm i infrastrukturës mbitokësore, e cila do t'iu krijon kushte me te mira te | Komuna – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit në bashkëpunim me Zyrën e Kryetarit. | Komuna Kaçanik | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| projekti me qellim te arritjes se Marreveshjes se Bashkefinancimit me Ministritë e linjës).<br>B) Projektet per zhvillimin e turizmit, shuma 50,000.00 €, | | | levizjes dhe qarkullimit të njerzëve dhe mallrave.<br><br>Perfundimi i projekteve afatgjata ne bashkepunim me Ministritë e linjes dhe Donatoret tjerë. | | | |
| | | | | | | |
| **1.11** Regjistrimi i vazhdueshëm i bizneseve, regjistrimi i shuarjeve dhe ndryshimeve te bizneseve. | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Ekzekutimi i të gjitha aplikacioneve sipas aplikacioneve të paraqitura. | MTI, QRBK-KAÇANIK | Komuna Kaçanik | |
| **1.12** Hartimi i Planin të ri Komunal për Efiqiencë të Energjisë (PKEE) 2022-2024 dhe Planit komunal të Veprimit për Efiçiencë të Energjisë (PKVEE) 2022-2024 | mars-nëntor<br><br>2022 | Komuna<br><br>Kaçanik | Kursimi i energjisë, ruajtja e mjedisit, zhvillimi ekonomik dhe ngritja e konforit në ndërtesat komunale. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit<br><br>DSHPE-ja<br><br>DZHE-ja<br><br>DAK-ja<br><br>GIZ-i | | MZHE, Agjencia e Kosovës për Efiçiencë të Energjisë |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1.13** Luftimi i ekonomisë Jo-Formale përmes inspektimeve te rregullta të tregut komunal. | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Shtimi i numrit të bizneseve legale-të regjistruara, krijimi i konkurrencës lojale. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit - INSPEKTORIATI I TREGUT. | | |
| **1.14** Listimi i të gjitha pronave komunale të cilat janë në dispozicion për investitor të ndryshëm | janar qershor 2022 | Komuna Kaçanik | Bindja e investitorëve vendor dhe të huaj për investime në veprimtari të ndryshme. | Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit,Zyra e Kryetarit DKUKMM,DESHP. | | |
| **<u>TURIZMI:</u>** | | | | | | |
| **1.1** Projektet për zhvillimin e turizmit, realizimi i projekteve sipas listes së projekteve të parapara për vitin 2022 | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Hartimi i projekteve për zhvillimin e turizmit në zonat turistike. | Komuna Kaçanik – Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit,<br>MTI-DEPARTAMENTI I TURIZMIT. | | |
| **1.2** Identifikimi i lokacioneve dhe potencialeve turistike si dhe promovimi i tyre. | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Zhvillimi I turizmit, nxitja e investimeve ne turizëm, rritja e nivelit te punësimit etj. | Komuna Kaçanik - Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit,<br>MTI-DEPARTAMENTI I TURIZMIT | | |
| **1.3** Bashkëpunimi me komunat tjera partnere në programet turistike dhe menaxhimi i mirë i | janar-dhjetor 2022 | Komuna Kaçanik | Pjesëmarrja në projektet ndërkomunale dhe angazhimi i resurseve tona në këto projekte. | Komuna Kaçanik dhe Komunat Partnere. | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| projekteve që vijnë si donacion në fushën e turizmit**.** | | | | | | |

**Plani i Punës së Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë**

| **Aktivitetet e planifikuara** | **Koha dhe vendi i implementimit të aktiviteteve** | | **Rezultatet e pritura nga aktivitetet e zhvilluara** | **Partnerët implementues të aktiviteteve** | **Buxheti** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Koha** | **Vendi** | | | **Komuna** | **Donacione** |
| **1. Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë kordinon dhe organizon punët brenda drejtorisë** | | | | | | |
| 1.1 Mbajtja e regjistrit mbi gjendjen e dokumentacionit brenda drejtorisë. | janar – dhjetor 2022 | DBZHRP (Zyra e sektorit për bujqësi) Kaçanik | Mbajtja e regjistrit për kërkesat e parashtruara nga qytetarët, vendosja me kohë e kërkesave, njoftimi i qytetarëve lidhur me vendosjen e kërkesave, mbajtja e | Sektori për Bujqësi dhe Pylltari | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Përcjellja dhe mbajtja e evidencës për të gjitha aktivitetet e zhvilluara në viset rurale | | | evidencës për të gjitha aktivitetet e zhvilluara në viset rurale | | | |
| 1.2 Bashkëpunimi me MBPZHR në projektet e subvencionimit të fermerëve (pranimi dhe kompletimi aplikacioneve me dokumentet e kërkuara për aplikim. Digjitalizimi i parcelave të fermerëve që aplikojnë për subvencionimin e kulturave të mbjellura (grurit, misrit, pemëve dhe perimeve) si dhe pranimin aplikacioneve për subvencionim të fermerëve për lopë qumështore dhe kafshë të imta ( dele dhe dhi), bletë etj. | mars– tetor 2022 | DBZHRP( Zyra e sektorit për bujqësi) Kaçanik | Përfitimi i fermerëve nga projektet e subvencionimit dhe grantet e ofruara prej MBPZHR | DBZHRP dhe MBPZHR | | |
| 1.3 Mbledhjen e të dhënave bujqësore për mbjelljet pranverore, vjeshtore, prodhimtarinë e kulturave bujqësore, prodhimtarinë blegtorale, shfrytëzimin e tokës | janar-dhjetor 2022 | Zyra e sektorit për bujqësi Kaçanik | Sigurimin dhe ruajtjen e evidencave të sakta për prodhimtarinë e kulturave bujqësore, prodhimtarinë blegtorale si dhe shfrytëzimit të tokës bujqësore | Zyrtarët e Sektorit të Bujqësisë në bashkëpunim me udhëheqësit | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| bujqësore si dhe mbajtjen e evidencës për numrin e shoqërive me bletë etj. | | | | e fshatrave dhe fermerët | | |
| **2. Organizmi i trajnimeve dhe ofrimi i këshillave profesionale fermerëve** | | | | | | |
| 2.1 Organizmi i trajnimeve<br>me fermerë në të gjitha lëmitë bujqësore | mars-dhjetor 2022 | Kaçanik | Ngritjen e kapaciteteve teknike të fermerëve, me qëllim të ndikimit në rritjen e rendimenteve dhe përmirësimin e kualitetit të prodhimeve bujqësore, blektorale si dhe rritjen e të ardhurave për ekonomit familjare bujqësore në zonat rurale | DBZHRP-së në bashkëpunim me MBPZHR-së | | |
| 2.2 Ofrim i këshillave profesionale fermerëve për prodhimtarinë bimore dhe blegtorale<br>(Shpërndarja e broshurave për fermerë) | shkurt-<br>tetor 2022 | Kaçanik (Zyra e DBZHRP-së) | Fitim të njohurive për mënyrat e përdorimit të teknikave të reja buqësore në prodhimtarinë bujqësore dhe blegtorale . | DBZHRP – Zyrtarët e Sektorit të Bujqësisë | | |
| | | | | | | |
| **3. Mbrojtja e tokës bujqësore** | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.1 Kontrollime në mbrojtjen e tokave bujqësore nga ndërtimet | janar–dhjetor 2022 | Kaçanik | Organizimi i kontrolleve në terren nga ana e inspektorëve, informim i qytetarëve lidhur me Ligjin për tokat bujqësor, për ndalimin e ndërtimeve në tokat bujqësore, pa pëlqimin e DBZHRP dhe marrjen e lejës së ndërtimit në DUKMM | Bashkëpunimi Sektorit të Bujqësisë me inspektorin Komunal të ndërtimtarisë | | |
| 3.2 Monitorimi i projekteve 2019-2021 | shkurt- tetor 2022 | Kaçanik (fermerët përfitues) | Monitorimi i kohëpaskohshëm i fermerëve përfitues të projekteve të drejtorisë, me qëllim të eliminimit të keqpërdorimit të subvencioneve nga ndonjë përfitues. | Zyrtarët e sektorit të Bujqësisë në bashkëpunim me komisionin Komunal për ndarjen e subvencioneve | | |
| 3.2 Mbajta e evidencës për ndërrim destinimin e tokës bujqësore | janar-dhjetor 2022 | DBZHRP-Sektori i Bujqësisë | Evidentimi i sipërfaqes së tokës bujqësore që i është ndërruar destinimi nga toka bujqësore në ndërtimore, bazuar në Vendimet e lëshuara për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në atë ndërtimore. | Zyrtarët e Sektorit për Bujqësi | | |
| 3.3 Kontrollime fushore mbi gjendjen e bimëve gjatë vegjetacionit | mars–nëntor 2022 | DBZHRP-Sektori i Bujqësisë | Organizimi i kontrolleve mbi gjendjen e kulturave bujqësore, evidentimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve që mund të paraqiten gjatë zhvillimit vegjetacionit | DBZHRP-Zyrtarët e Sektorit të Bujqësisë | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | bimor, me qëllim të marrjes së masave për luftimin sëmundjeve dhe dëmtuesve që mund të paraqiten. | | | |
| **4. Bashkëpunimi me OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare për mbështetje të fermerëve** | | | | | | |
| 4.1 Takime me OJQ –ët vendore, ndërkombëtare, me qëllim të bashkëpunimit për gjetjen e mundësive për mbështetje të fermerëve me projekte . | shkurt- dhjetor 2022 | Zyret e Sektorit të Bujqësisë dhe OJQ-ëve | Organizim të vizitave OJQ-ve me qëllim të realizimit të projekteve të mundshme me interesë për fermerët | Kryetarit i komunës, Drejtoria e BZHRP, OJQ-ët | | |
| **5 .Implementimi i projekteve në kuadër të drejtorisë BZHRP** | | | | | | |
| 5.1 Planifikimi i projekteve të parapara për vitin 2022 | janar 2022 | DBZHRP | Informimi i kryetarit dhe Ekzekutivit lidhur me projektet e DBZHRP | Zyra e kryetarit, Drejtoria për buxhet dhe financa, DBZHRP | | |
| 5.2 Mbështetja e fermerëve me mekanizëm bujqësor (freza për tërheqje me traktor, kultivator , spërkatëse për kultura lavërtare dhe shpërndarëse të plehut mineral). | 2022 shkurt- korrik | Kaçanik | Nxitjen e fermerëve për punimin e tokës në mënyrë cilërore, ndikimit në kultivimin e kulturave bujqësore si dhe në rritjen e rendimentit | DBZHRP si dhe Drejtoria për buxhet dhe financa, si dhe fermerët me participim në projekt 20 % | **50,736.00€** | **12,684.00€** Participimi fermerëve 20% |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | |
| 5.3<br>Projekti për mbështetje të fermerëve me fidanë të pemëve (arrë dhe Kumbullë) | gusht- nëntor 2022 | Kaçanik | Mbështetja e fermerëve me fidanë të arrës dhe kumbullës për ngritjen e plantacioneve të reja me pemishte | DBZHRP si dhe Drejtoria për buxhet dhe financa, si dhe fermerët me participim në projekt 20 % | **14,176.00€** | **3,544.00€**<br>Participimi fermerëve 20% |
| 5.4<br>Projekti për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në fshatin Doganaj, Soponicë, Nikaj. | mars-tetor 2022 | Doganaj<br>Nikaj<br>Soponicë | Mbështetje të fermerëve për ujitjen e kulturave bujqësore, zvoglim i fuqisë punëtore dhe i shpenzimeve, krijim të lehtësirave për fermerët, shfrytzim më racional i ujit për ujitje të tokave bujqësore, rritjen e rendimentit tek kulturat bujqësore. | DBZHRP si dhe Drejtoria për buxhet dhe financa | **50.000.00€** | |
| | | | | | | |
| **6. Organizimi i Punës në Sektorinë e Pylltarisë** | | | | | | |
| 6.1 Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave për prerje të masës drusore në pyjet e sektorit privat, për vitin 2022 | janar –mars 2022 | DBZHRP-Sektori i Pylltarisë | Ofrim të shërbimeve për pronarët e pyjeve private, në vulosjen e masës drusore të lejuar për prerje për vitin 2022, menaxhimin e prerjes së | DBZHRP-Sektori i Pylltarisë, APK- Drejtoria kordinuese Ferizaj | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | pyjeve private sipas Ligjit për pyjet | | | |
| **7. Organizimi në mbrojtjen e pyjeve Publike** | | | | | | |
| 7.1 Hartimi i planeve për vënje në kontrollë të tereneve për secilin rojtarë të pyjeve | janar – dhjetor 2022 | DBZHRP-Sektori i Bujqësisë | Rritjen e efikasitetit në mbrojtjen e pyjeve para shkaktimit të dëmit (prerjes) së pyjeve | Rojtarët e pyjeve dhe kordinatori i sektorit pylltarisë dhe zyrtari për mbrojtje dhe kultivim të pyjeve | | |
| 7.2 Organizimi i kontrollave të përbashkëta me policinë në rrugë, për pengimin e transportuesve ilegal. | janar-dhjetor 2022 | DBZHRP-Sektori i Bujqësisë | Pengimin e transportimit ilegal të masës drusore | Inspektori i Pylltarisë, rojet e pyllit dnë bashkëpunim me Policinë e Kosovës | | |
| | | | | | | |
| 7.3 Përgaditja e fletëparaqitjeve të ofruara nga rojtarët e pyjeve | janar-dhjetor 2022 | DBZHRP-Sektori i Bujqësisë | Zvoglimin e prerjeve nga prerësit ilegal, ndikimi në vetëdijsimin e qytetarëve | Kordinatori i sektorit të pylltarisë dhe tekniku pyjor | | |
| **Damkosja e masës drusore të lejuar nga Zyrtarët e APK –ës për sektorinë privat sipas kërkesave të pranuara** | | | | | | |
| 8.1 Publikimi i planit të dëmkosjes së masës drusor të lejuar për | prill – dhjetor 2022 | DBZHRP-Sektori i Bujqësisë | Informimi i pronarëve për caktimin e afatit kohor për damkosje, | DBZHRP- kordinatori i sektorit të pylltarisë dhe rojet e pyjeve | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| prerje sipas caktimit të terenit | | | ofrim të shërbimeve në kohë | | | |
| **9. Zbatimi i planit të hartuar nga APK-ja për shfrytëzimin e pyjeve publike në ngastrat e caktuara për prerje të masës drusore si dhe pyllëzimi dhe regjistrimi i terreneve** | | | | | | |
| 9.1 Përgatitja Ankandit sipas procedurave të prokurimit | shkurt-tetor 2022 | DBZHRP-Sektori i Bujqësisë | Dhënia me tender e ngastrave të caktuara për prerje, operatorëve ekonomik të cilët i plotësojnë kushtet sipas procedurave të prokurimit . | DBZHRP- Sektori i Pylltarisë dhe Zyra e Prokurimit | | |
| 9.2 Monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve të operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e pyjeve publike | prill- nëntor 2022 | DBZHRP-Sektori i Bujqësisë | Realizimi planit të paraparë për vitin 2022 në shfrytëzimin e pyjeve | DBZHRP- Sektori i Pylltarisë | | |
| 9.3 Regjistrimi i terreneve nga prerjet ilegale | tetor-dhjetor 2022 | DBZHRP-Sektori i Pylltarisë | Regjistrimi i dëmeve sipas rajoneve për secilin rojtar të pyjeve | DBZHRP- sektori i pylltarisë, APK-Ferizaj | | |
| 9.4 Rrallimet para komerciale | maj-tetor 2022 | DBZHRP – Sektori i Pylltarisë | Përmirsimi dhe shtimi i fondit pyjor në sipërfaqet e planifikuara | DBZHRP–sektor i pylltarisë dhe APK- Ferizaj | | |
| **Koordinimi i aktiviteteve të drejtorisë** | | | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9.6 Organizmi i takimeve të rregullta javore, me stafin e sektorit të bujqësisë dhe sektorit të pylltarisë me qëllim informimit drejtorit dhe stafit për gjendjen e punës dhe aktivitete që duhet ndërmarr për rritjen e efikasitetit të punës së drejtorisë | janar- dhjetor 2022 | DBZHRP | Mbajtja në kontrollë e gjendjes së pyjeve përmes koordinimit të aktiviteteve, organizimit të takimeve me stafin e sektorit të bujqësisë dhe pylltarisë, për të ndikuar në rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të punës, parandalimin e prerjeve ilegale të pyjeve si dhe ofrim më të mirë të shërbimeve për qytetarë. | DBZHRP | | |

Kryetari i Komunës

**Besim Ilazi**

______________________________

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| Data 18.01.22 | | Vendi KAÇANIK |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 60/01-1764 | -/- |

# Raport i Punës së Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara për vitin 2021

Kaçanik,2022

# Përmbajtja

Përmbajtja ....................................................................................................2

Lista e Shkurtesave.........................................................................................3

Fjala e Kryesuesit të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizuara..................4

Përmbledhja ekzekutive ...............................................................................5

Korniza Ligjore..............................................................................................6

I. Mbledhjet......................................................................................................7

II. Takimet ........................................................................................................7

III. Hartimi i Planit të Punës 2021.................................................................8

IV. Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021.8

V. Kërkesat ......................................................................................................9

VI Pjesëmarrja në punëtori të ndryshme..................................................... 9

VII. Aktivitete avokuese..................................................................................9

Lista e Shkurtesave

PAK –Personat me Aftësi të Kufizuara

PLVPAK- Plani Lokal i Veprimit Për Personat me Aftësi të Kufizuara

KKPAK- Komiteti Konsultativ Për Persona me Aftësi të Kufizuara

KKZ- Komisioni Komunal i Zgjedhjeve-Kaçanik

# FJALA E KRYESUESIT TË KKPAK-së

I nderuari, Kryesues i Kuvendit Komunal të Kaçanikut, Z. Kemajl Murseli,

Të nderuar anëtar,

Në kuadër të obligimeve të legjislacionit në fuqi, në raport me KKPAK-në përkatësisht Udhëzimit Administrativ(MAPL)Nr01.2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, ne si Komitet paraqesim raportin e punës përgjatë vitit kalendarik 2021. Si Komitet që përfaqëson interesat e komunitetit të PAK-ve në Komunën e Kaçanikut, dhe me një periudhë të shkurtër të punës, jemi munduar që punën tonë ta fokusojmë në avancimin e çështjes së aftësisë së kufizuar duke u munduar që atë ta ngrisim në nivele të prioriteteve në dy drejtime; në atë institucional dhe atë shoqëror Mirëpo, një pengesë drejtë kësaj përpjekje padyshim ka qenë edhe pandemia Covid -19 që ka ndikuar në punën e KKPAK-së, angazhimet profesionale e institucionale të disa anëtarëve të KKPAK-së si dhe trajtesa jo në nivel të duhur nga ana e autoriteteve komunale në raport me KKPAK-në,

Të nderuar anëtar,

Komuniteti i PAK-ve është një nga komunitetet shoqërore më të margjinalizuara si nga sfidat personale të tyre por po ashtu edhe nga pamundësia dhe pengesat sociale e institucionale në raport me ta. Kjo veçse është vështirësuar në këto dy vitet e fundit edhe me sfidën e pandemisë COVID-19. Kjo na bën të konstatojmë se problemet dhe sfidat e personave me aftësi të kufizuara në komunën tonë janë të mëdha. Mirëpo, ne si komitet kemi shpresë dhe bindje se një qasje më pro-aktive një koordinim më i mirë institucional dhe një vullnet i përgjithshëm më i madh është garanci në arritjen e qëllimit tonë të përbashkët: përmirësimin e çështjes së aftësisë së kufizuar në komunën tonë. Meqenëse viti 2022 nga Qeveria e Republikës së Kosovës është shpallur si vit i Personave me Aftësi të Kufizuara besojmë që edhe Komuna e Kaçanikut do e trajton çështjen e aftësisë së kufizuar në nivele të tilla të prioriteteve.

Me respekt, Artan Mezraja

Kryesues i Komitetit Konsultativ për Persona me Aftësi të Kufizuara

## Përmbledhje ekzekutive

Ky raport paraqet punën dhe aktivitetet e ndërmarra nga ana e Komitetit për gjatë periudhës janar – dhjetor të vitit 2021. Komiteti ka zhvilluar një numër takimesh ad hoc për të përcaktuar agjendën e punës së komitetit përgjatë vitit 2021 e në të cilat takime edhe është e fokusuar më së shumti edhe vetë puna e komitetit në përgjithësi. Megjithatë që në fillim duhet pranuar që Pandemia Covid-19 ka ndikuar edhe në punën dhe aktivitetet e KKPAK-së duke pamundësuar realizimin e disa aktivitete të planit të punës për vitin 2021.

Komiteti ka mbajtur vetëm një (1) mbledhje të rregullt në të cilën janë shqyrtuar çështje të ndryshme. Gjithashtu një pjesë e aktiviteteve ka qenë e rezervuar në monitorimin e Planit të Veprimit të Personave me Aftësi të Kufizuara 2019-2021 të miratuar nga ana e Kuvendit të Komunës së Kaçanikut. Brenda këtij raporti janë pasqyruar edhe aktivitetet që Komiteti ka bërë jashtë institucioneve me qëllim avancimin e çështjes së aftësisë së kufizuar.

Korniza Ligjore

Komitetet Konsultative janë trupa ndihmëse të Kuvendit të Komunës, roli i të cilave është që përmes këtyre komiteteve të garantohet që organet e komunave të jenë më transparente, më efikase dhe të japin më shumë llogari qytetarëve. Si të tilla ato mund të angazhohen në : dhënien e propozimeve për rregullore të ndryshme; hulumtime të ndryshme; japin mendime dhe ide rreth iniciativave të ndërmarra nga kryetari i komunës, komitetet e përhershme apo kuvendi i komunës në fushën përkatëse; paraqesin pikëpamjet dhe mendimet e qytetarëve te kryetari i komunës dhe kuvendi i komunës; japin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.

Baza e funksionimit të këtyre komiteteve mbështetet në këto dokumente ligjore: Ligjin Nr. 03/L-40- Për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në Udhëzimin Administrativ(MAPL)Nr01.2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna

Përbërja:

Artan Mezraja Kryesues

Mirlinda Axhami Zv- Kryesuese

Argjenta Axhami Anëtarë

Antigona Axhami Anëtarë

Edita Shehu Anëtarë

Fiknete Krasniqi Anëtarë

*Mbledhjet*

Në bazë të Udhëzimit Administrativ(MAPL)Nr01.2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna janë të përcaktuara në bazë të "nevojave por së paku duhet të mbahen gjashtë(6)takime në vit". Megjithatë KKPAK ka mbajtur vetëm një mbledhje gjatë këtij viti duke mos përmbushur kuotën normative prej 6 mbledhjeve Brenda vitit. Kjo mungesë e mbajtjes së mbledhjeve ka ardhur si rezultat i dy faktorëve: viti 2021 ka qenë vit elektoral në Kosovë dhe kjo ka ndikuar tek disa anëtar të Komitetit që të jenë pjesë aktive e menaxhimit të këtyre zgjedhjeve(kryesuesi i KKPAK-së z. Artan Mezraja por edhe një anëtar i KKPAK-së ka qenë pjesë e kandidaturës në zgjedhjet lokale( zëvendës kryesuesja Mirlinda Axhami Hysa), prandaj pezullimi i aktiviteteve për të mos u keqkuptuar politikisht ka ndikuar edhe ne faktorin e dytë që një pjesë e anëtarëve nuk kanë mbajtur mbledhje vetëm për statistika dhe evidencë mëditjesh.

Në mbledhjen e parë të vitit 2021 e cila është mbajtur me datën 30.04.2021 ku janë diskutuar çështje të ndryshme siç janë:

1. Shqyrtimi i disa kërkesave nga OJQ-të;

3. Informatë rreth takimit me Handikos- Kaçanik;

4. Planifikimi dhe organizimi i një tryeze për PAK ; dhe

5. Të ndryshme.

Brenda kësaj mbledhje janë diskutuar edhe çështje të tjera.

***Takimet***

Fokusi i punës së KKPAK-së më së shumti është i koncentruar në takime të ndryshme si nga vetë anëtarët e komitetit po ashtu edhe ndërmjet institucioneve, organizatave apo individëve të ndryshëm. Vlen të theksohen takimet e ndryshme që kemi pasur me Kryetarin e Komunës Z. Besim Ilazi në të cilën takime janë adresuar dhe diskutuar tema të ndryshme që nga përmirësimi i legjislacionit (taksat komunale) e deri tek adresimi kërkesave të organizatave Empoëer edhe Handikos. Në këto takime është kërkuar nga Kryetari dhe nënkryetari që të behët më shumë rreth punësimit të personave me aftësi të kufizuar, duke e vënë në informim kryetarin mbi kuotën e

punësimit të PAK-ve në institucionet komunale dhe mos plotësimin e saj nga institucionet komunale.

Një takim është mbajtur edhe me Handikosin i thirrur po nga ata ku janë trajtuar sfidat e implementimit të legjislacionit për PAK-të.

Një takim është mbajtur edhe me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në Kaçanik ku temë diskutimi ka qenë Përfshirja e PAK-ve në trupat menaxhuese të zgjedhjeve, ku si rezultat i këtij takimi është arritur që në zgjedhjet lokale si anëtarë të këshillave të Vendvotimit të punësohen gjashtë(6 ) persona me aftësi të kufizuara, duke plotësuar kështu edhe kuotën ligjore nga ana e KKZ-së që çdo i 50 person i punësuar të jetë nga PAK-të.

Po ashtu me datën 2 dhjetor është mbajtur një takim online me anëtarët e komiteteve të PAK-ve të disa komunave ku janë diskutuar sfidat e KKPAK-ve dhe mundësitë e bashkëpunimit në të ardhëm për krijimin e agjendave të përbashkëta avokuese.

***Hartimi i Planit të Punës për vitin 2022***

Brenda kësaj periudhe janë zhvilluar disa takime për të hartuar planin e punës për vitin 2022, i cili plan është duke u hartuar dhe miratohet në mbledhjen e radhës.

***Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021***

Një nga aktivitetet ku është konsumuar kohë në punën e Komitetit ka qenë edhe Monitorimi i Zbatimit të Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2019-2021. Ky monitorim është bërë duke përdorur dy lloje metodash , atë të vrojtimit të drejtpërdrejtë si dhe metodën e intervistimit të shumë bartësve të institucioneve lidhur me të gjitha objektivat e parapara në këtë dokument. Nga ky monitorim vërejmë se ky PLVPAK nuk është zbatuar në shumësi, pavarësisht disa plotësimeve të tij. Mirëpo, marrë parasysh që ky plan ka qenë i paraparë për tre vite dhe si dokument nuk është valid mbetet shqetësuese për të ardhmen që komuna jonë nuk ka një dokument strategjik për çështjen e aftësisë së kufizuar.

*Kërkesat*

Si pjesë e punës sonë ka qenë edhe dëgjimi i kërkesave të personave me aftësi të kufizuara dhe adresimi i tyre tek autoritetet komunale. Një nga këto kërkesa në formën verbale ka qenë nga organizata Handikos që si komitet t'i ndihmojmë në promovimin por edhe ndikimin tek autoritetet komunale për përkrahje institucionale rreth start up-it të tyre në prodhimin e sapunëve të lëngshëm.

*Pjesëmarrja në punëtori të ndryshme*

Një pjesë e anëtarëve të komitetit kanë qenë për dy ditë pjesë aktive e punëtorisë për Hartimin e Strategjisë së Punës për organizatën Handikos në Kaçanik.

*Aktivitete avokuese*

Me datën 2 dhe 3 dhjetor në kuadër të Ditës Ndërkombëtare për Persona me Aftësi të Kufizuara janë mbajtur ligjërata sensibilizuese me nxënës në 4 shkolla fillore në komunën e Kaçanikut për integrimin e PAK-ve në jetën sociale e publike. Gjithashtu në këtë datë është mbajtur edhe një takim me nënkryetarin e komunës Z. Ylber Bajra ku është kërkuar që si institucione të bëjnë më shumë për PAK-të dhe që viti 2022 të jetë po ashtu vit prioritar edhe për komunën e Kaçanikut për PAK-të.

**Kryesuesi i KKPAK**

**Artan Mezraja**

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT REPUBLIKA KOSOVA OPŠTINA KAČANIK

KAÇANIKU

| | |
|---|---|
| **Republika e Kosovës** | **Komuna e Kaçanikut** |
| **Republika Kosova** | **Opština Kacanik** |
| **Republic of Kosovo** | **Municipal Kacanik** |

01. 104/02-1853/22

Kaçanik, 15.07.22

Në bazë të nenit 17 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2021 MPB 03/2021 MAPL Për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, Kryetari i Komunës, për Kuvendin Komunal jep këtë:

# PROPOZIM

Që Komiteti për politikë dhe Financa, në mbledhjen e radhës, të shqyrton dhe aprovon duke proceduar në procedura të mëtejme në Kuvendin e Komunës këtë:

# VENDIM

## PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

I. Themelohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Komunën e Kaçanikut.

II. Përbërja e KKSB do të jetë:

1. Kryetari i Komunës- Kryesues
2. Komandanti i Stacionit Policor në Kaçanik
3. Përfaqësuesi i Këshillit të Bashkësisë Islame në Kaçanik
4. Përfaqësuesi nga Komunitetet etnike pakicë në komunë
5. Kryesuesi i Komitetit për Komunitetet

6. Zyrtari për Barazi Gjinore
7. Drejtori i Drejtorisë për Arsim
8. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit
9. Përfaqësuesi i FSK-së
10. Përfaqësuesi i Këshillit Lokal për Siguri Publike
11. Kryesuesi i Ekipit Veprues Komunal për Siguri në Bashkësi
